



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë

“Master i Shkencave” në “Farmaci”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “REALD”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Entela Hodaj

2. Prof.Dr. Mirela Lika (Çekani)

Janar / 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Farmaci”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar “REALD”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “REALD”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Farmacisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program i integruar studimi i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Farmaci”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 650, datë 14.09.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 409, datë 11.09.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 399, datë 22.07.2016 (me kusht); Urdhër Nr. 20, datë 20.01.2017 (plotësimi i kushteve)
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	300
11	Forma e studimit:	
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	18 PAE / 4 PAK (22-23)
18	Numri i studentëve:	– 18-19: 8 studentë të regjistruar për herë të parë; – 19-20: 11 studentë të regjistruar për herë të parë; – 20-21: 16 studentë të regjistruar për herë të parë; – 21-22: 34 studentë të regjistruar për herë të parë; – 22-23: 27 studentë të regjistruar për herë të parë.

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i integruar i studimit i ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Farmaci”, ofrohet nga Departamenti i Farmacisë, pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore, të Kolegjit Universitar “REALD”. Ky program është hapur me VKM Nr. 650, datë 14.09.2011 dhe është akredituar me kusht me Urdhër Nr. 399, datë 22.07.2016 dhe Urdhër Nr. 20, datë 20.01.2017 për plotësimin e kushteve. Programi i studimit realizohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, në 5 vite akademike, me 300 ECTS dhe i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Ky program i përgjigjet nevojës së tregut duke u përballur me sfidat e kohës jo vetëm në zonën ku zhvillohet, në Vlorë, por edhe në nivel kombëtar. Ky program studimi paraqet interes për studentët, për faktin që është i integruar dhe ofron mundësi punësimi në fushën e farmacisë. Organizimi është bërë në mënyrë që të arrihet një harmonizim sa më i mirë i leksioneve, seminareve dhe orëve laboratorike duke u fokusuar në ndërthurjen e teorisë me praktikën laboratorike në përputhje me natyrën e formimit për profesionin e farmacistit që ofron ky program studimi.

Në dispozicion të studentëve, si dhe për realizimin me sukses të këtij programi studimi është një infrastrukturë bashkëkohore didaktike duke përfshirë këtu jo vetëm auditorët, por edhe laboratorët mësimorë, bibliotekën, përdorimin e internetit, si dhe të gjitha facilitetet e tjera që mundësojnë një mësimdhënie cilësore, jo vetëm në ecurinë e zakonshme, por edhe në kushtet e vështira të pandemisë.

Institucioni bashkëpunon me institucione të ndryshme publike dhe private, ku mundëson jo vetëm formimin profesional të studentëve, por edhe ndihmon dhe mbështet studentët në rrugën e punësimit. Kjo mbështetet nga mjaft marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo private, si dhe me sektorin e farmaceutikës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në Kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, 2017”, Kolegji Universitar “REALD” ka aplikuar nëpërmjet sistemit AMS, për nisjen e procesit të riakreditimit të programit të studimit të integruar Master i Shkencave në “Farmaci”.

Raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB) për programin e studimit MSc “Farmaci” i ofruar nga Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Kolegji Universitar “Reald” (KUR), dhe dokumentacioni mbështetës, është përgatitur nga një ekip, i cili përfshin anëtarë të stafit akademik si dhe përfaqësues të studentëve.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm për këtë program studimi përbëhet nga Prof. Dr. Mirela Lika (Çekani) dhe Dr. Entela Hodaj. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm GVJ është mbështetur nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Ersi Dako.

GVJ ka shqyrtuar RVB, si dhe të gjitha evidencat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion përpara zhvillimit të vizitës në institucion. Përmes leximit të dokumentacionit GVJ u familjarizua me strukturën, politikën, menaxhimin, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe aktivitetet kryera nga IAL, si dhe konkretisht nga stafi i programit të studimit.

GVJ realizoi një sërë takimesh gjatë vizitës në institucion, gjë e cila i mundësoi grupit vlerësues të kuptojë qartë këndvështrimet e stafit dhe studentëve. GVJ u takua me përfaqësues të autoriteteve drejtuese të KUR dhe FSHM, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, personelin akademik të departamentit dhe të programit të studimit, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të zyrave mbështetëse të procesit mësimor, dhe aktiviteteve akademike e kërkimore të Departamentit. Gjithashtu GVJ realizoi dhe një vizitë në ambjentet e brendshme të institucionit, që lidheshin kryesisht me programin e studimit, vizitoi klasat, laboratorët mësimorë, sekretarinë mësimore, bibliotekën, etj. Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, si dhe gjithë informacionin e mbledhur gjatë vizitës, GVJ arriti në konkluzionet të cilat janë dhënë në fushat përkatëse.

Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm u përcoll në IAL, përmes AMS më datë 08.01.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 31 Prot., datë 09.01.2024.

IAL përcolli përgjigjen mbi Draft-Raportin me shkresë Nr. 14 Prot., datë 11.01.2024, përmes së cilës ka shprehur dakordëinë e tij me përmbajtjen e Draft-Raportit. Për sa më lart, Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm kthehet në Raport përfundimtar.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Programi i studimit është akredituar me kusht me Urdhër Nr. 399, datë 22.07.2016. Kushtet e lëna në këtë urdhër, janë konsideruar të plotësuara me Urdhër Nr. 20, datë 20.01.2017, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 220, datë 16.12.2016.

Vlerësimi i programit të integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Farmaci”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i integruar i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Farmaci”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë, Kolegji Universitar “Reald”, Vlorë (KUR), duke ju referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, vihet re se nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ky program studimi synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare në fushën e farmacisë. Zhvillimet multidisiplinare janë prioritet strategjike për të garantuar karrierë profesionale konkurruese në tregun global në kuadrin e farmacistit, dhe gjithnjë mbetet i orientuar të njihet në shkallë rajonale, evropiane dhe më gjerë. (Evidenca 2, Statuti i KUR, neni 4, pika 4.1).
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Stafi i KUR, ka hartuar dhe ofron në përputhje me qëllimet dhe misionin e tij, programin e studimit të integruar të nivelit të dytë në “Farmaci”. Nga dokumentacioni në dispozicion vihet re se ky program ofrohet në fushën e veprimtarisë së tij. (Evidenca 2 Statuti i KUR; Evidenca 4 Rregullore e përgjithshme e IAL; Evidenca 6 Rregullore e programit të studimit Master shkencash “Farmaci”).
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Në Statutin, Strategjinë dhe Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të KUR (Evidenca 2 Statuti i KUR; Evidenca 3 Strategjia e KUR; Evidenca 4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit KUR) , përshkruhet qartë se Programi i integruar i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të KUR, si edhe në përshtatje dhe me fushat e drejtimit akademike të institucionit. Programet e studimit pasqyrojnë vullnetin e institucionit për zbatimin e strategjisë afatgjatë të zhvillimit të institucionit.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit	Programi është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit të sistemit arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimi gjatë gjithë jetës (Evidenca 3 Strategjia e zhvillimit institucional të KUR) Ky program është

mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	hartuar në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë në Shqipëri, dhe si pjesë e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Procesit të Bolonjës nga viti 2003.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare, ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, si edhe të Statutit dhe Rregullores. Institucioni ka demonstruar se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga dokumentacioni në dispozicion, si dhe nga takimi me autoritetet e KUR, vihet re që Institucioni ka përvojën dhe kapacitetet për ofrimin e programit të studimit të integruar MSc në “Farmaci”. Programi i integruar MSc. në “Farmaci” ofrohet nga Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Personeli akademik i këtij Departamenti ka në përbërjen e tij 12 anëtarë efektiv, ku 1 mban titullin Prof. As., 2 mbajnë gradën shkencore Dr. dhe 5 janë Msc., dhe 4 anëtarë me kontratë, ku 1 mban titullin Prof.As., 1 mban gradën shkencore Dr. dhe 2 janë Msc. (Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 3. Lista e stafit akademik të DF dhe stafi i angazhuar në programin e studimit Msc. Farmaci - viti akademik 2022-2023).
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programit i integruar i studimit, sipas evidencave që disponojmë, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Programi është sipas klasifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. (Evidenca 4 Rregullore e IAL; Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore; Evidenca 6 Rregullore e Programit të Farmacisë; Evidenca 39 Tabela e kodifikimit të programeve të studimit; Evidenca 44 Plani mësimor i programit).
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, që synon dhënien e njohurive në formimin e përgjithshëm teorik dhe praktik në fushën e farmacisë, me objektivin kryesor formimin e specialistëve në këtë

programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	fushë, të aftë për të punuar si mjekë farmacistë. (Evidenca 6 Rregullore e programit të studimit).			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Institucioni nuk ofron program "Master Profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga takimet me stafin, Departamenti i Farmacisë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar. Përmes veprimtarive shkencore, që organizohen nga Urdhëri i Farmacistit dhe KUR, apo në rastet kur KUR ka bashkëpunime me IAL të tjera, për marrjen e njohurive të nevojshme për rritjen e shkallës së kualifikimit, apo dhe konferenca shkencore në fushën e Farmaceutikës në bashkëpunim me Universitetin e Salernos, etj. (Evidenca 81 Konferencë Shkencore Ndërkombetare; Evidenca 85 Leksion i hapur).			
Konkluzione	<i>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga takimi me personelin akademik të Departamentit dhe Njësise kryesore, u pohua se autoritetet e KUR ju kanë krijuar mundësinë për marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit. Dekani i Fakultetit gjithashtu pohon se ekziston një marrëdhënie bashkëpunimi e vazhdueshme për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, sa më sipër pasqyrohet edhe në analizën vjetore institucionale. (Evidenca 2 Statuti i KUR; Evidenca 4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit KUR; Evidenca 5 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të Fakultetit të shkencave mjeksore; Evidenca 40 Struktura akademike e FSHM; Evidenca 92 Raporti vjetor 2021-2022).

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga dokumentacioni në dispozicion, si edhe nga takimi me stafin akademik të Departamentit dhe të FSHM, vihet re qartë se në fokus të bashkëpunimeve janë institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit. Për këtë qëllim, institucioni ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi (Evidenca 25, 26, 27, 28, 31 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit), nëpërmjet të cilave synohet të sigurohet që përfituesit të jenë studentët dhe personeli. Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, janë të pasqyruara në analizën vjetore institucionale (Evidenca 92 Raporti vjetor 2021-2022).
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Sic u theksua edhe në Standartin I.3, Kriteri 2, KUR ka shumë marrëveshje bashkëpunimi me institucione, farmaci dhe universitete të ndryshme (Evidenca 25, 26, 27, 28, 31 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL, Urdhërin e Farmacistit). Fakulteti i Shkencave Mjekësore, ku bën pjesë edhe Departamenti i Farmacisë ka marrëveshje bashkëpunimi në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor me Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Universitetin Privat “Albanian University”, Akademinë “Ivodont”, Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, Universitetin e Barit në Itali; Universitetin e Salernos në Itali; Universitetin Katolik të Mursias në Spanjë, Universitetin Jasi në Rumani., etj Ajo që tërheq vëmendjen në Departamentin e Farmacisë për këtë program studim është që departamenti ka marrëveshje të posaçme midis subjekteve shtetërore dhe private, për realizimin e praktikave profesionale në profilin farmaceutik (Evidenca 29, 30 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Farmacite për zhvillimin e praktikave). Në funksion të programit të studimit dhe sidomos të praktikave janë marrëveshjet e nënshkruara me disa farmaci. Që prej vitit 2022 stafi i Departamentit i Farmacisë është partner në projektin europian “Blue Arrow”, me Universitetin e Foggia-s (Itali) dhe Universitetin Shtetëror të Barcelonës, (Spanjë) (Evidenca 89 Dokumentacioni i projektit Blu Arrow).
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në dokumentat e vëna në dispozicion nga institucioni, jepen raporte të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Nga takimi me stafin akademik të programit të studimit, rezultojnë që të dhënat e mësipërme pasqyrohen në mbledhjet periodike të Departamentit të Farmacisë, ku ofrohet programi i studimit MSc “Farmaci”, si dhe janë pjesë e analizës vjetore të tij. (Evidenca 92 Raporti vjetor 2021-2022; Evidenca 111 Raport analitik për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me farmacitë private).
Konkluzione	<i>IAL ju ka krijuar mundësinë për marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit. Në funksion të programit të studimit dhe sidomos të</i>

	<i>praktikave, janë marrëveshjet e nënshkruara me disa farmaci. Departamenti i Farmacisë për këtë program studimi ka marrëveshje të posaçme midis subjekteve Farmaci, për realizimin e praktikave profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga dokumentacioni në dispozicion shihet që: Programi i studimit të integruar MSc “Farmaci” është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, sipas legjislacionit në fuqi: <i>Ligji Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 dhe VKM Nr.875, datë 18.12.2019</i> dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). (Evidenca 43 Programi mësimor i integruar i studimit Msc. Farmaci 2022-2023, Tabela 9.1 dhe 9.2). Lëndët e programit të studimit janë kategorizuar sipas tipit të komponentit mësimor me përqindjet përkatëse: Kategoria A – 60 ECTS / 20 % Kategoria B – 151 ECTS / 50.3 % Kategoria C – 43 ECTS / 14.3 % Kategoria D – 26 ECTS / 8.7 % Kategoria E – 20 ECTS / 6.7 %.
	Nga Evidenca 43: Programi mesimor, si dhe nga Evidenca 44: Plani mësimor, rezultojnë përqëndrime të tjera – përkatësisht: Kategoria A 19%, Kategoria B 56%, Kategoria C 16%, Kategoria D 6%, Kategoria E 3%; ndërsa nga Tabelat 9.1 dhe 9.2 kanë dalë përqindjet e sipërpërmendura, pra, duke konstatuar mospërputhje.

	<i>Për sa më lart, evidentohet se kategoritë D dhe E nuk janë plotësisht në përputhje me % që kërkohet sipas VKM 41 të ndryshuar, pasi sipas VKM kategoria D duhet të jetë 6-8%, ndërkohë që është 8.7%, ndërsa kategoria E, sipas VKM duhet të jetë 3-5 %, ndërkohë që është 6.7 %. Gjithashtu, GVJ gjykon se ka disa objeksione në lidhje me natyrën e lëndëve, ku lëndë me natyrë pothuajse të njëjtë, për shkak të arritjes së %, klasifikohen në kategori të ndryshme.</i> Ky Program studimi përmban 300 kredite të ndara në pesë vite mësimore (dy semestra çdo vit) me nga 60 kredite në vit (30 kredite për semestër) (Evidenca 4 Rregullore e studimeve të KUR, Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, Evidenca 6 Rregullore e Departamentit të Farmacisë, Evidenca 43 Programi mësimor i programit të integruar MSc “Farmaci” Evidenca 44 Plani mësimor i programit të studimit).
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i integruar i studimit MSc. “Farmaci” synon në formimin e shprehive me fokus teorinë dhe praktikën. Ky program, siç edhe pohohet nga stafi akademik i tij, është hartuar mbi bazën e kërkesave dhe nevojave të tregut, duke siguruar jo vetëm një formim bazë, por edhe një profilizim të studentëve në fushën farmaceutike. Ai mbulon një spektër të gjerë disiplinash në fusha të ndryshme që përfaqësohen nga lëndët përkatëse: Bazat e anatomisë, fiziologjisë, biokimisë; Aspektet fiziopatologjike të organizmit, si dhe njohuri mbi disa nga sëmundjet kryesore të tij; Mbi grupet e ndryshme të medikamenteve, origjinën e tyre, mënyrat e përthithjes dhe eliminimit nga organizmi; Kiminë organike, inorganike, fizike e koloidale dhe shumë aspekte të analizës kimike. Në fushën e përgatitjes profesionale ata do të marrin njohuri të përshtatshme për: Teknologjitë farmaceutike në përgatitjen e medikamenteve të ndryshme; Testimet fizike, kimike, biologjike e mikrobiologjike të këtyre medikamenteve; Metabolizmi dhe efektet e produkteve farmaceutike në organizëm; Njohjen e saktë të efekteve anësore të tyre; Kërkesat ligjore që lidhen me aktivitetin e një farmacie; Magazinimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e produkteve farmaceutike me shumicë; Organizimin e aktivitetit në farmacitë publike dhe private; Aspektin etik, deontologjik dhe human të profesionit të farmacistit; etj. Këto lëndë sigurojnë formimin e shprehive të veçanta në fushën e farmacisë, zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca në fushë profesionale, të nevojshme për fushën e farmacisë. (Evidenca 43 Programi i studimit Msc. në Farmaci).

Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se institucioni ka përfshirë në planin mësimor të programit ngarkesën për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, përkatësisht: praktika profesionale ka 20 ECTS dhe mbrojtja e diplomës (mikroteza) ka 20 ECTS. Veprimtaritë formuese për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse vlerësohen me kredite dhe janë përcaktuar sipas legjislacionit vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) <i>Sikurse cituar dhe në kriterin 1 të këtij standardi, % e parashikuar për kategorinë D, ku përfshihet edhe praktika profesionale, nuk është në përputhje me parashikimet e VKM 41, e ndryshuar, pasi sipas kësaj VKM-je nuk duhet të jetë 6-8%, ndërkohë që është 8.7%. (Evidenca 44 Plani Mësimor i studimit, Evidenca 52 Libri I praktikës mësimore të studentëve).</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nuk aplikohet për këtë program studimi.

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet e realizuara në institucion, nga IAL deklarohet se programi i studimit i integruar i nivelit të dytë Master i Shkencave në “Farmaci”, ofrohet në të njëjtën fushë studimi, dhe me të njëjtën emërtesë si programe të tjera të ngjashme, si dhe ka përmbajtje të ngjashme jo ka përmbajtje të ngjashme rreth 70 % me lëndët e kategorisë A programit të integruar MSc. në “Stomatologji”, të ofruar nga KUR. (Evidenca 44 Plani mësimor i programit).			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Institucioni ka propozuar kodin e programit të studimit MSc. në Farmaci, sipas VKM nr. 310, datë 11.05.2022, “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin nr. 31, datë 15.11.2022 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Procesi i kodifikimit të programeve të studimit nga MAS është ende në proces dhe nuk ka përfunduar. Emërtimi i programit është në përputhje me nivelin e e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Të gjitha lëndët kanë kodin e tyre përkatës. Kodet e vendosura për çdo lëndë tregojnë vitin, dhe semestrin kur zhvillohet lënda në procesin mësimor. (Evidencë nr. 39: Tabela e kodifikimit të programeve të studimit në KUR).			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i integruar i studimit i ciklit të dytë në “Farmaci” ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “REALD”, nuk është program i përbashkët me ndonjë prej institucioneve të arsimit të lartë, vendas apo të huaj.			
Konkluzione	GVJ evidenton se kategoritë D dhe E nuk janë plotësisht në përputhje me % që kërkohet sipas VKM 41 të ndryshuar, pasi sipas VKM kategoria D duhet të jetë 6-8%, ndërkohë që është 8.7%, ndërsa kategoria E, sipas VKM duhet të jetë 3-5 %, ndërkohë që është 6.7 %. Gjithashtu, GVJ gjykon se ka disa objeksione në lidhje me natyrën e lëndëve, ku lëndë me natyrë pothuajse të njëjtë, për shkak të arritjes së %, klasifikohen në kategori të ndryshme. Programi i studimit i integruar i nivelit të dytë Master i Shkencave në “Farmaci”, ofrohet në të njëjtën fushë studimi, dhe me të njëjtën emërtesë si programe të tjera të ngjashme, si dhe ka përmbajtje të ngjashme rreth 70 % me lëndët e kategorisë A programit të integruar MSc. në “Stomatologji”, të ofruar nga KUR.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																					
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit është Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Ky fakultet përbëhet nga katër njësi bazë: Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, Departamenti i Stomatologjisë, Departamenti i Farmacisë dhe Departamenti i Veterinarisë. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Farmacisë. Kjo njësi përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike. Përbërja e Departamentit të Farmacisë, përgjatë viteve akademike që prej akreditimit të parë të këtij programi, paraqitet si në vijim: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>22-23</td><td>8 PAE me kualifikimin: 1 Prof.Dr., 2 Dr. 5 Msc.</td><td>4 PAK me kualifikimin: 1 Prof.As., 1 Dr., 2 Msc.</td></tr><tr><td>21-22</td><td>9 PAE me kualifikimin: 1 Prof.Dr., 2 Dr., 6 Msc.</td><td></td></tr><tr><td>20-21</td><td>9 PAE me kualifikimin: 2 Prof.Dr., 3 Dr., 4 Msc.</td><td>1 PAK me kualifikim Msc.</td></tr><tr><td>19-20</td><td>7 PAE me kualifikimin: 2 Prof.Dr., 2 Dr., 3 Msc.</td><td>1 PAK me kualifikim Msc.</td></tr><tr><td>18-19</td><td>8 PAE me kualifikimin: 2 Prof.Dr., 2 Dr., 4 Msc.</td><td>1 PAK me kualifikim Msc.</td></tr><tr><td>17-18</td><td>7 PAE me kualifikimin: 1 Prof.Dr. 1 Prof.As., 3 Dr., 1 SPA, 1 Msc.</td><td></td></tr></table>	Viti akademik	PAE	PAK	22-23	8 PAE me kualifikimin: 1 Prof.Dr., 2 Dr. 5 Msc.	4 PAK me kualifikimin: 1 Prof.As., 1 Dr., 2 Msc.	21-22	9 PAE me kualifikimin: 1 Prof.Dr., 2 Dr., 6 Msc.		20-21	9 PAE me kualifikimin: 2 Prof.Dr., 3 Dr., 4 Msc.	1 PAK me kualifikim Msc.	19-20	7 PAE me kualifikimin: 2 Prof.Dr., 2 Dr., 3 Msc.	1 PAK me kualifikim Msc.	18-19	8 PAE me kualifikimin: 2 Prof.Dr., 2 Dr., 4 Msc.	1 PAK me kualifikim Msc.	17-18	7 PAE me kualifikimin: 1 Prof.Dr. 1 Prof.As., 3 Dr., 1 SPA, 1 Msc.	
Viti akademik	PAE	PAK																				
22-23	8 PAE me kualifikimin: 1 Prof.Dr., 2 Dr. 5 Msc.	4 PAK me kualifikimin: 1 Prof.As., 1 Dr., 2 Msc.																				
21-22	9 PAE me kualifikimin: 1 Prof.Dr., 2 Dr., 6 Msc.																					
20-21	9 PAE me kualifikimin: 2 Prof.Dr., 3 Dr., 4 Msc.	1 PAK me kualifikim Msc.																				
19-20	7 PAE me kualifikimin: 2 Prof.Dr., 2 Dr., 3 Msc.	1 PAK me kualifikim Msc.																				
18-19	8 PAE me kualifikimin: 2 Prof.Dr., 2 Dr., 4 Msc.	1 PAK me kualifikim Msc.																				
17-18	7 PAE me kualifikimin: 1 Prof.Dr. 1 Prof.As., 3 Dr., 1 SPA, 1 Msc.																					
	(Evidenca 40 Struktura akademike e FShM; Tabelat përmbledhëse, tabela 2; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 3. Lista e stafit akademik të DF dhe stafi i angazhuar në programin e studimit Msc. Farmaci - viti akademik 2022-2023).																					

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nga evidencat e paraqitura dhe takimet në institucion nuk kemi konstatuar angazhim të personelit ndihmës akademik apo administrativ, për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i ka kushtuar një rëndësi të veçantë organizimit të praktikës profesionale, duke i mundësuar studentëve realizimin në mënyrë korrekte brenda afatit të caktuar në kalendarin akademik, në saj edhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me institucionet e praktikave siç janë farmaceutë, etj. Studentët ndiqen në vijimësi nën drejtimin e një pedagogu të përcaktuar nga departamenti. Duke ju referuar evidencës 30: Marrëveshje bashkëpunimi me farmaci private lokale (model) dhe evidencës 32: Vendim për caktimin e koordinatorit të praktikës profesionale të studentëve, shihet që koordinatori i programit të studimit është caktuar në detyrë nga njësia kryesore. Sikurse parashikuar dhe pohuar nga koordinatori: <i>koordinatori i programit të studimit mbështet planifikimin, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit të studimit që mbulon, për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektivave të programit.</i> Në aktet e brendshme rregullatore të KUR, nuk ka asnjë parashikim rregullator për statusin e koordinatorit të programit, si zgjidhet, detyrat etj. (Evidenca 30: Marrëveshje bashkëpunimi me farmaci private lokale (model); Evidenca 32: Vendim për caktimin e koordinatorit të praktikës profesionale të studentëve).			
Konkluzione	<i>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit ka minimalen si personel akademik me tituj e grada, për ta angazhuar në programin e studimit të integruar MSc. “Farmaci”.</i> <i>Koordinatori i programit i caktuar nga njësia përgjegjëse, nuk është personel akademik me kohë të plotë brenda kuadrit ligjor dhe sipas funksionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita që u zhvillua në KUR, takimi me stafin akademik të Departamentit të Farmacisë, u verifikua që ky departament disponon informacionet e nevojshme për organizimin (personelin akademik, mjediset etj.) strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit (plani mësimor etj.). Sikurse cituar dhe në RVB, programi i studimit është organizuar në përputhje me procesin e Bolonjës, duke realizuar ndarjen në module me përmbajtje të detajuar dhe vlerësuar me kredite (ECTS). Programi i studimit është hartuar në mënyrë që të ketë ngjashmëri me programe brenda dhe jashtë vendit duke bërë të mundur njëkohësisht njohjen dhe transferimin e studimeve. Departamenti disponon dosjen e programit të studimit, në të cilën janë të administruara gjithë dokumentacioni i nevojshëm. (Evidenca 6 Rregullore e programit të studimit; Evidenca 43 Programi i studimit i detajuar; Evidenca 44 Plani mësimor i programit të studimit; Evidenca 46 Syllabuset e lëndëve/moduleve; Evidenca 95 Infrastrukturën e nevojshme akademike për zhvillimin e programit të studimit).
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni, rezulton se programi i integruar i studimit në “Farmaci” përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për lëndët që zhvillohen gjatë pesë viteve të studimit, ngarkesën mësimore dhe orët në auditor e jashtë auditorit. Një vit akademik zhvillohet në 30 javë mësimore dhe përbëhet nga dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor ose jashtë auditorit, si edhe praktikat. Në planin mësimor janë të paraqitura ngarkesa (leksion, seminar, laborator, ushtrime dhe detyra kursi) në orë mësimore në auditor të lëndëve/moduleve sipas viteve dhe semestrave, si dhe kreditet e tyre sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). (Evidenca 43 Programi mësimor i integruar; Evidenca 44 Plani mësimor i programit të studimit; Evidenca 46 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit).
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga takimi me stafin akademik të programit të studimit, si edhe studentët del në pah programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Më konkretisht, kriteret e pranimi të studentëve në programin e integruar të studimit “Farmaci” paraqiten në rregulloren e programit të studimit. (Evidenca 6 Rregullore e Programit të Studimit MSc “Farmaci”). Siç u theksua në Kriteret më sipër, edhe mundësia e transferimit të studentëve në programe të ngjashme të të njëjtit cikël brenda institucionit apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, janë të evidentuara në dokumentat e

	paraqitura (Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore). Studentët informohen kryesisht nga faqa web: www.unireald.edu.al, ku njihen me kurrikulat, kriteret, gjuhën, etj. Programi i studimit përmban gjithë informacionin e duhur për pranimet, transferimet dhe ekuivalentimet. Senati akademik, miraton kriteret e pranimit të studentëve për vitin pasardhës, të cilat miratohen nga MAS. (Evidenca 6 Rregullore e programit të studimit; Evidenca 33 Vendim i SA për miratimin e kriterëve të pranimit).			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga dokumentacioni në dispozicion vihet re që programi i integruar i studimit MSc “Farmaci” përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për leksionet, seminarin apo praktikën, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. (Evidenca 4 Rregullore e studimeve të IAL). (Evidenca 43 Plani mësimor i programit të studimit; Evidenca 46 Syllabuset e lëndëve të programit të MSc “Farmaci”).			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Në fillim të çdo viti akademik, miratohen ndryshimet eventuale për përditësimin e vazhdueshëm dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë. Dokumentacioni ruhet dhe në format elektronik pranë Sekretarisë Mësimore dhe pranë NJSBC. (Evidenca 9 Rregullore NJSBC; Evidenca 6 Rregullore e programit).			
Konkluzione	<i>Programi i studimit është informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. Programi i studimit MSc “Farmaci” përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore për secilën lëndë për leksionet, seminarin apo praktikën, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave,	Nga dokumentat në dispozicion dhe takimet me personelin akademik të programit mësimor dhe të Departamentit të Farmacisë, del se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve

mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	dhe praktikave të programit të studimit mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve. Kjo e fundit pohohet edhe nga studentët, në takimin që GJV kishte me ta. Marrëveshjet me klinikat farmaceutike, së pari ndihmojnë studentët në zhvillimin e praktikave dhe së dyti, krijojnë mundësi për intership-e dhe punësim, në klinikat ku janë përfshirë në këto praktika. (Evidenca 44 Plan i Mësimor i programit të studimit; Evidenca 78 Punësimi i studentëve në Farmaci 2016-2021).
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe kërkimit shkencor.	Nga dokumentat rezultojnë që ngarkesat (leksion, seminar, laborator, ushtrime dhe detyra kursi) e lëndëve/moduleve zhvillohen në orë mësimore në auditor të lëndëve/moduleve sipas viteve dhe semestrave, si dhe kreditet e tyre sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës. (Evidenca 43 Programi mësimor i integruar i studimit Msc. Farmaci 2022-2023; Evidenca 44 Plan i mësimor i programit të integruar Msc. ne Farmaci 2022-2023) Programi i studimit përputhet me fushën e studimit, dhe kjo reflektohet në 36 lëndët obligative, në përputhje dhe me numrin e krediteve dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Studentët përfitojnë kompetenca përmes programeve të lëndëve, praktikave mësimore, etj. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme: - Lëndë bazë të programit të studimit, që lidhen me përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme: 20% të krediteve; - Lëndë karakterizuese, që lidhen me përgatitje për disiplinën shkencore: 50.3% të krediteve; - Lëndë ndërdisiplinore/integruese, që lidhen me nëndisiplinën, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje: 14.3% të krediteve; - Lëndë plotësuese, që lidhen me gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktikën profesionale: 8.7% të krediteve; - Detyrime përmbyllëse: 6.7% të krediteve. <i>Sikurse është cituar dhe me herët, % e kategorive D dhe E nuk janë në përputhje me VKM 41 e ndryshuar.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Në bazë të dokumentave, RVB dhe takimeve të zhvilluara, struktura e programit përputhet plotësisht me profilin e programit aktual, ngarkesa në kredite dhe raporti teori-praktikë janë të përafërta me programe të ngjashme kombëtare/ndërkombëtare. Nga 300 kredite që përmbush programi mësimor, praktika profesionale si lëndë më vete ka 20 kredite (ECTS). Gjatë gjithë programit të studimit, studentët kryejnë edhe orë të tjera punë laboratorike klinike.

	Raporti i praktikave me pjesën teorike është në përputhje me programet e studimit të ngjashme, si p.sh., me Universitetin e Barit. Organizimi i praktikave të studentëve nëpërmjet marrëveshjeve të formalizuara që KUR zhvillon me institucionet publike, depot dhe farmacitë private mundëson një ndërlidhje më të mirë të programeve të studimit me nevojat e shoqërisë dhe kërkesat e tregut të punës. (Evidenca 29 Lista e farmacive me të cilat KUR ka marrëveshja për kryerjen e praktikës profesionale; Evidenca 44 Plan i mësimor i programit të integruar Msc. në Farmaci 2022-2023).
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, me referencë kryesore Ligjin 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi, në FSHM ofrohet programi i integruar i studimit i nivelit të dyt në "Farmaci". Në këtë program të integruar, realizohet ndarja sipas veprimtarive, si edhe raportet midis formimit teorik dhe praktik, si dhe gjithashtu mundësohet dhe transferimi i studimeve. <i>Megjithatë, siç është theksuar dhe me lart, raportet midis veprimtarive formuese A, B, C, D, E, nuk janë tërësisht në përputhje me ato të përcaktuara nga ligji.</i> Rregullorja e Fakultetit parashikon mundësinë e transferimit të studimeve bazuar në kreditet e fituara. Fakulteti pranon transferime studentësh në vite të ndërmjetme nga universitete të tjera dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitete të tjera, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e KUR. Evidenca nr. 5: Rregullore e FShM (nenet 31, 32, 33); Evidenca 6 Rregullore e programit MSc në Farmaci).
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Në lidhje me Syllabuset (programet e lëndëve/moduleve) është diskutuar edhe në Kriteret e mësipërme. Nga takimi me stafin u vu re që ato përditësohen në mënyrë të vazhdueshme nga titullari i lëndës, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse. Kjo realizohet gjatë ndjekjes së praktikave me studentët, të qenurit koherentë me tregun e punës, pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme shkencore etj. Duke ju referuar edhe dokumentave (Evidenca nr. 44. Plan i mësimor i programit të integruar Msc. në Farmaci 2022-2023; Evidenca 46 Syllabuset e programit; Evidenca nr. 98. Lista e librave në fushën e farmacisë që ndodhen në bibliotekën e IAL) dhe RVB, të gjitha lëndët përditësohen duke marrë parasysh zhvillimet e fundit shkencore si dhe përmbajtjen dhe literaturën e ofruar, me qëllim të plotësimit të kërkesave bashkëkohore në lidhje me arritjen në fushën e farmaceutike.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Stafi akademik i Departamentit të Farmacisë ka patur një bashkëpunim të mirë me farmaci të ndryshme dhe shpesh aty janë realizuar praktika punësimi, në sajë të këtij bashkëpunimi. Ky

	internship/përvojë praktike, shpesh është konsideruar si periudhë prove trajnimi dhe kjo ka ndikuar pozitivisht në lidhje me punësimin. Përmbajtja e programit të studimit, i siguron kompetenca dhe aftësi profesionale për të qenë të sukseshëm dhe për t'u përshtatur në tregun e punës për studentët e diplomuar. (Evidenca 6. Rregullore e programit MSc në Farmaci.pdf; Evidenca 44. Plan i mësimor i programit të integruar Msc. në Farmaci. 2022-2023; Evidenca 29. Lista e farmacive me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikës profesionale; Evidenca 30. Marrëveshje bashkëpunimi me farmaci private për kryerjen e praktikës mësimore – Model; Evidenca 31. Marrëveshje bashkëpunimi Urdhërin e Farmacistit).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave për të qenë farmacistë të aftë në tregun e punës, si dhe vijimin e mëtejshëm të studimeve. Këto objektiva janë konform Direktivës 2005/36/EC të Këshillit dhe Parlamentit Europian, si dhe konform Ligjit për Arsimin e Lartë dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit. (Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit; Evidenca 6. Rregullore e Programit të Studimit Msc “Farmaci”; Evidenca 30. Marrëveshje bashkëpunimi me farmaci private për kryerjen e praktikës mësimore – Model; Evidenca 31. Marrëveshje bashkëpunimi Urdhërin e Farmacistit; Evidenca 43. Programi i studimit)			
Konkluzione	GVJ konstaton se përmbajtja e programit, ndarja sipas kategorive formuese, duhet të ishte në raporte pak më të mira dhe sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Megjithatë, ai përsëri garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në përputhje me standartet në përgatitjen e specialistëve. Zhvillimi i praktikave të studentëve, realizohet nëpërmjet marrëveshjeve të lidhura me institucione të ndryshme të farmacive. Studentët pas diplomimit janë punësuar pikërisht në subjektet ku ata kanë zhvilluar praktikën.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi-II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Për një program mësimor, që të jetë sa më i përshtatshëm dhe efikas me kërkesat e tregut të punës, njësia bazë ka bashkëpunuar dhe marrë parasysh propozimet e stafit të krahasuara dhe ballafaquar edhe me programet e ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nga farmacistët me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi për praktikat mësimore. (Evidenca 2. Statuti i IAL; Evidenca 7. Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës; Evidenca 8. Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Evidenca 25. Lista e IAL-ve me të cilat KUR ka marrëveshje bashkëpunimi; Evidenca 30. Marrëveshje bashkëpunimi me farmaci private për kryerjen e praktikës mësimore; Evidenca. Marrëveshje bashkëpunimi me Urdhrin e Farmacistit).
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Zyra e Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar (ALUMNI), <i>por pa i përfshirë ata për përmirësimin e përmbajtjes së programit mësimor MSc. (PI) në Farmaci. Studentët në këtë program ishin të motivuar, por nuk shprehnin asnjë vërejtje për kurrikulën, duke mos kontribuar në përmirësimin e programit.</i> (Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL; Evidenca 66. Te dhena për nr. studentëve të diplomuar në 5 vitet e fundit; Evidenca 7. Rregullore e Këshillimit të Karrierës).
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Mendojmë se njësia bazë ka realizuar përmirësime, përditësime, apo përshtatje të programit të studimit, në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën e farmacisë, e cila realizohet në përputhje me propozimet e stafit të Departamentit të Farmacisë, që bashkëpunon me institucione publike e private, si dhe me Urdhërin e Farmacistit për të njohur me propozimet e tyre për përshtatjen e programit të studimit në përputhje me propozimet e tyre. (Evidenca nr. 6. Rregullore e programit MSc në Farmaci; Evidenca 31. Marrëveshje bashkëpunimi me Urdhrin e Farmacistit; Evidenca 27. Marrëveshje bashkëpunimi me UMT; Evidenca 28. Marrëveshje bashkëpunimi me Albanian University. Evidenca. Lista e farmacive me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikës profesionale).
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se njësia bazë ka bashkëpunuar dhe marrë parasysh propozimet e stafit të krahasuara dhe ballafaquar edhe me programet e ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nga farmacistët me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi për praktikat mësimore. GVJ gjykon se nuk ka përfshirje të studentëve në vendimmarrje për përmirësimin e kurrikulave, pavarësisht se</i>

	<i>mendojmë që kurrikula ekzistuese është në tërësi në funksion të lëndëve profesionale dhe në funksion të kualifikimit më të mirë të studentëve në fushën farmaceutike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor janë përcaktuar në Strategjinë e Kërkimit Shkencor, e cila është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Institucional. Bazë në hartim kanë qenë objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë të zhvillimit, si dhe janë realizuar studime të tregut, cilësia, barazia dhe standardet, gjenerimi i ideve të reja dhe informacionet në fushën e kërkimit shkencor. Objektivat dhe prioritetet kryesore janë të koordinuara në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2017-2022) dhe në bashkërendim me MASR. (Evidencë 43. Programi i studimit; Evidenca 80. Strategjia dhe plani i punës afatmesëm i kërkimit shkencor për periudhën 2019 – 2024). Evidenca. Plani pune për Kërkimin Shkencor).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga takimet me strukturat kryesore, evidentohet se respektohet liria akademike e personelit akademik në fushën e veçantë të studimit të secilit prej stafit akademik të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, i cili koordinon bashkëpunimin ndërmjet njësive bazë për nxitjen dhe bashkërendimin e veprimtarisë mësimore-kërkimore. Nga RVB dhe dokumentacioni i dorëzuar evidentohet se aktivitetet kërkimore planifikohen në fillim të vitit akademik dhe miratohen nga Senati Akademik. Por, gjatë vitit mund të zhvillohen edhe aktivitete të tjera të propozuara nga njësitë bazë apo nga institucione të tjera me të cilat IAL bashkëpunon. Nga takimi me njësinë e kërkimit, avancimi në karrierën akademike mbështetet në tregues që kanë të bëjnë me publikimet, përfshirjen në projekte të ndryshme kërkimore shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare. (Evidenca 90. Plani pune i kërkimit shkencor; Evidenca 92. Raport vjetor i IAL; Evidenca nr. 94. Lista e konferencave shkencore të organizuara nga KUR).
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit dhe marrëveshjet që janë midis departamentit të Farmacisë me IAL kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe lidhja me përditësimet e Urdhërit të Farmacistëve, kanë krijuar të gjitha mundësitë për nxitjen dhe motivimin e studentëve, në mënyrë që ata të angazhohen për kryerjen e veprimtarive të ndryshme mësimore

	si, detyrave të kursit, punëve praktike, punëve laboratorike, projekte të ndryshme sipas disiplinave mësimore. <i>Mendojmë se studentët duhet të përfshihen dhe në punë kërkimore, apo dhe në projekte të ndryshme kërkimore.</i> (Evidenca 86. Aktivitete të zhvilluara në kuadrin e “Ditës ndërkombëtare kundër HIV/AIDS”; Evidenca 81. Konferencë Shkencore Ndërkombëtare IPTTPH 2019, në bashkëpunim me University of Salerno; Evidenca 83. Konferencë shkencore “Promocion në Shëndet”, me temë: “Kanceret e aparatit riprodhues femëror – një shqetësim madhor për këtë grup popullate”, 2020).			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Njësia bazë, për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore mbështetet financiarisht nga KUR. Sipas GVB si dhe takimeve me stafin, krijimi dhe përdorimi i burimeve financiare në KUR bëhet në bazë të një programi financiar afat-mesëm, i hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara në IAL, si dhe në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008. (Evidencë 2. Statuti IAL; Evidencë 35. Vendim i BA për miratim fondi për kërkimin shkencor). Programi financiar, pasi hartohet nga Rektorati si dhe pasi është bërë objekt diskutimi në Senat Akademik miratohet nga Bordi i Administrimit.			
Konkluzione	Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhore të institucionit. Prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor janë përcaktuar në Strategjinë e Kërkimit Shkencor, e cila është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Institucional. Bazë në hartim kanë qenë: objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtare të zhvillimit, si dhe janë realizuar studime te tregut, cilësia, barazia dhe standardet, gjenerimi i ideve të reja dhe informacionet në fushën e kërkimit shkencor, por GVJ gjykon se kërkimi shkencor, e aq më tepër përfshirja e studentëve në kërkim shkencor, nuk është në nivelin e duhur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7 Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Farmacisë përbëhet nga 8 anëtarë staf me kohë të plotë dhe për këtë arsye nuk ka grupe mësimore-kërkimore. Nga takimet e realizuara në institucion, evidentohet se stafi i angazhuar në këtë program studimi, për realizimin e objektivave të programit të studimit në aspektin mësimor dhe në kërkim shkencor, bashkëpunon me qendrën kërkimore të KUR për zhvillimin e aktiviteteve shkencore. Në IAL hartohet Plani i punës kërkimore shkencore për vitin akademik. Ky plan i veprimtarisë kërkimore-shkencore bashkërendohet me Qendrën e Kërkimit. (Evidenca 90. Plan pune i kërkimit shkencor; Evidenca 91. Raporti vjetor i Kërkimit Shkencor).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon kryesisht personelin akademik. <i>Kërkimi shkencor është parë më tepër si rezultat i nismave individuale të pedagogëve.</i> Avancimi në karrierë i personelit akademik varet kryesisht nga rezultatet në punën kërkimore, ndërkohë që kujdes i kushtohet performancës në mësimdhënie. Sipas raportit vjetor të NJSBC, studentët janë pjesë aktive e aktivitetit të kësaj strukture, apo si dhe në raportin e vlerësimit të programit të integruar të ciklit të dytë Msc. në "Farmaci", ku pjesë e grupit të punës është edhe një studente. <i>Megjithatë, sikurse cituar dhe në standardin më lart, kërkimi shkencor dhe përfshirja e studentëve në kërkim shkencor, nuk është në nivelin e duhur.</i> (Evidenca 72. Raport i NJSBC; Evidenca 93. Formular aplikimi për t'u anëtarësuar në EAFP).
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	KUR dhe njësia kryesore organizojnë konferenca ose aktivitete, të cilat kanë ndihmuar stafin si dhe studentët për arritjen e objektivave. Departamenti i Farmacisë ka qenë bashkëpunues me departamente të tjera të Fakultetit të Shkencave Mjekësore në konferenca dhe aktivitete shkencore, për shkak dhe të afërsisë së fushave të kërkimit. (Evidenca 81. Konferenca shkencore ndërkombëtare Innovation Practices and Technological Transferto the Pharmacy Area - 2019 , Evidenca 82. Programi i konferencës Shkenca dhe Inovacioni 2021 ; Evidenca 94. Lista e konferencave të zhvilluara në IAL, 2017-2022).
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit synon të formojë profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, duke përdorur dijet, praktikën dhe teknologjinë. (Evidenca 72. Raport i NJSBC).

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nga takimet e realizuara me stafin dhe NJSBC, evidentohet se njësiti përgjegjëse bashkëpunojnë për të ndihmuar në punësimin e studentëve. Sikurse cituar dhe nga institucioni, Zyra e Karrierës dhe Alumni ndihmon studentët të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes, për t’u integruar lehtësisht në tregun e punës. Zyra mban kontakte me Urdhërin e Farmacistit lidhur me afatet e dhënies së provimeve, regjistrimin e praktikave dhe kohën e punësimit për të aplikuar për marrjen e licencës profesionale sipas akteve ligjore. (Evidenca 114. Shkresë e Urdhrit të Farmacistit për provimin e shtetit; Evidenca 7. Rregullore e Keshillimit të Karrieres).		
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i integruar i studimit Master i Shkencave në Farmaci, që përfshihet në profesionet e rregulluara, përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian. (Evidenca 115. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).		
Konkluzione	<i>Stafi i angazhuar në këtë program studimi, për realizimin e objektivave të programit të studimit në aspektin mësimor dhe në kërkim shkencor, bashkëpunon me qendrën kërkimore të KUR për zhvillimin e aktiviteteve shkencore.</i> <i>Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon kryesisht personelin akademik, megjithatë kërkimi shkencor është parë më tepër si rezultat i nismave individuale të pedagogëve. Gjithashtu, përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor nuk është në nivelin e duhur.</i> <i>Programi i studimit synon të formojë profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, duke përdorur dijet, praktikat dhe teknologjinë.</i> <i>Programi i studimit Msc Farmaci, që përfshihet në profesionet e rregulluara, përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, të parashikuara edhe në rregulloret e institucionit (Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore; Evidenca 6. Rregullore e programit MSc në Farmaci) në përputhje me këtë programi studimi, janë: Leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet, praktikat profesionale, etj. Raporti teori/praktikë në këtë program studimi, që mbështetet me laboratore dhe praktika profesionale, është në raporte relativisht të drejta. Pedagogu planifikon dhe përcakton metodat që do të përdorë gjatë zhvillimit të mësimin me në qendër studentin. (Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL; Evidenca 19. Udhëzues për hartimin e punimit të diplomës; Evidenca 85. Leksion i hapur “Profesionet e rregulluara dhe procedurat ligjore për marrjen e licencës së ushtrimit të profesionit”; Evidenca 87. Leksion i hapur “Mbrotjtja e jetës dhe e shëndetit).
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik përpiqet të respektojë dhe t’u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve. Ata ofrojnë metoda klasike të mësimdhënies e mësimnxënies, ku përfshihen leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat mësimore dhe profesionale. Gjithashtu ofrohen edhe forma alternative si projekte individuale apo në grup, prezantime detyrash kursi, etj. Personeli akademik përpiqet t’u përshtatet prirjeve individuale të studentëve duke hartuar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies, sidomos në kushtet e pandemisë, ku mësimi zhvillohej online. Institucioni vendosi në dispozicion të mësimdhënies online me studentët, me përdorimin e platformës open – access, Google Classroom. (Evidenca 34. Urdhëri i rektorit për zhvillimit të mësimin online; Evidenca 16. Google Classroom (Manual për studentin); Evidenca 17. Google Classroom (Manual për pedagogun); Evidenca 18. Manual për programin OBS për regjistrim video dhe audio).
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	KUR ka mbështetur dhe ofruar mundësinë e mobilitetit të personelit akademik pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike, pedagogjike dhe shkencore, <i>por nuk ka patur raste apo evidenca për stafin që jep në këtë program</i> . Institucioni ofron ambjente të përshtatshme në

	funksion të mbarëvajtjes së mësimdhënies: të gjitha sallat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme dhe me mjetet e nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor, etj. Të gjitha godinat mbulohen nga rrjet interneti ëireless, e disponueshme për të gjithë. (Evidenca 95. Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit; Evidenca 96. Laboratorët në IAL; Evidenca 97. Rack-u i lidhjes në rrjet dhe laborator i informatikës; Evidenca 98. Lista e librave në fushën e farmacisë që ndodhen në Bibliotekën e KUR; Evidenca 99. Lista e librave të rinj të shtuara në bibliotekë; Evidenca 100. Biblioteka on-line, lista e librave të disponueshëm në bibliotekën e KUR).
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar është kompetent në procesin e mësimdhënies (Evidenca 133 Cv Stafi ne programin Msc. Farmaci.pdf). Sipas ligjit 80/2015, neni 59, pika 6, personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Në këtë program studimi, në vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar në mësimdhënie 22 personel akademik, 18 prej të cilëve janë personel efektiv, ku 2 mbajnë titullin Prof., 6 kanë gradë shkencore Dr., 1 është SPA dhe 9 janë Msc., si dhe 4 janë personel akademik me kontratë, ku 1 është Prof. As., 1 Dr. dhe 2 Msc. Nga të dhënat sa më lart, duket se ka një numër relativisht të madh të stafit më Msc, gjë që duhet të ndryshojë në këtë program. Përdoren metoda interaktive dhe përfshihen në diskutime edhe studentët, me qëllim nxitjen e mendimit dhe aktivitetit krijues të tyre. Personeli akademik përdor teknika të ndryshme të mësimdhënies, si organizime në grupe për projekte, detyra kursi apo detyra individuale, te cilat diskutohen me gjithë grupin gjatë prezantimit. Këto aftësi përbëjnë dhe bazën për një marrëdhënie respekti dhe vlerësimi të ndërsjellë midis tyre. (Evidenca nr. 41. Stafi akademik i njesise bazë; Evidenca nr. 48. Te dhena mbi stafit akademik MSc. në Farmaci ne 3 vitet e fundit; Evidenca nr. 49. Kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mesimore të stafit akademik; Evidenca 101. Lista e mjeteve didaktike; Evidenca nr. 102. Lista e aseteve të luajtshme të KUR; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 3. Lista e stafit akademik te DF dhe stafi i angazhuar ne programin e studimit Msc. Farmaci - viti akademik 2022-2023).
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë	Departamenti i Farmacisë vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Bashkëpunimi i personelit akademik me studentët konsiston në informimin e plotë dhe të vazhdueshëm të tyre mbi lëndën, udhëzime dhe suport mbi



periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	realizimin e detyrave apo projekteve. Në këtë kuadër studentët plotësojnë në mënyrë periodike pyetësorët e vlerësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies si dhe aspekte të tjera të procesit që lidhen me laboratorët apo praktikat profesionale. KUR organizon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësimit të studentëve në Senatin Akademik në masën 10%, si dhe përfaqësimit në të gjitha komisionet e përhershme që organizohen në nivel Universiteti dhe në nivel Fakulteti. (Evidenca 2. Statuti i KUR; Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC).
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni organizon mirë struktura/njësi në nivel institucional, duke promovuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, si dhe koordinimin dhe bashkërendimin me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, si dhe në nxitjen e përdorimit të metodave dhe metodikave bashkëkohore në mësimdhënie dhe mësimnxënie. KUR ka në përbërje të saj strukturë akademike me funksion koordinimin institucional, kërkimit shkencor dhe projektet. Struktura ka organizuar aktivitete të ndryshme informuese mbi mundësitë që u ofrohen personleve akademike për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. (Evidenca 9. Rregullore e NJSBC; Evidenca 71. Plan pune i NJSBC; Evidenca 90. Plan pune i kërkimit shkencor; Evidenca nr. 92: Raporti vjetor i IAL). NJSBC, merret me monitorimin e procesit mesimor, aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Nëpërmjet pyetësorëve, studentët në anonimat të plotë shprehin mendimet, vërejtjet, apo sugjerimet e tyre jo vetëm për stafin akademik, por edhe për organizimin e studimeve dhe kushtet e zhvillimit të mësimin në IAL.
Konkluzione	<i>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, të parashikuara edhe në rregulloren e IAL dhe programit të studimit, janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet, praktikat profesionale, etj. Raporti teori/praktikë në këtë program studimi, që mbështetet me laboratore dhe praktika profesionale, është në raporte relativisht të drejta. Departamenti i Farmacisë vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Bashkëpunimi i personelit akademik me studentët konsiston në informimin e plotë dhe të vazhdueshëm të tyre mbi lëndën, udhëzime dhe suport mbi realizimin e detyrave apo projekteve, por personeli akademik që amgazhohet në programin e studimit duhet të ketë staf me grada dhe me tituj, pasi vihet re që ka një numër të konsiderueshëm me Msc.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme. bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e Studimeve të KUR, të FSHM, si dhe në rregulloren e programit të studimit. Këto janë publike në faqen ueb të KUR por, ju prezantohen studentëve si në fillim të studimeve, ashtu edhe para provimit të çdo lënde. (Evidenca 4. Rregulloren e Përgjithshme e KUR; Evidenca 5. Rregulloren e Përgjithshme e FSHM; Evidenca 6. Rregullore e programit të studimit “Farmaci”; Evidenca 10. Rregullore për zhvillimin e provimeve).
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në syllabuse, si dhe në fillim të çdo lënde/moduli, pedagogu titullar i lëndës informon studentët për të gjitha aspektet që lidhen me lëndën/modulin. Këtu përfshihen informacion i detajuar mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabusin, prezantimi i pedagogëve që do zhvillojnë aspekte të ndryshme të lëndës (module, laboratore, praktika profesionale). Informimi përfshin peshën specifike të secilit aspekt (teori/praktike apo vlerësim i vazhdueshëm/laborator/praktikë profesionale/provim final) në vlerësimin përfundimtar në përputhje me rregulloren e programit të studimit për syllabusin përkatës. (Evidenca 44. Plan i mësimor i programit të integruar Msc. në Farmaci. 2022-2023; Evidenca 46 “Syllabuset e programit të MSc Farmaci). Modeli i programit të lëndës, që përdoret për hartimin e syllabus-eve, përmban elementët sipas përcaktimeve në VKM nr. 41, datë 28.01.2018, të ndryshuar.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Përqindjen më të madhe të vlerësimit e zë provimi me shkrim, dhe pjesa tjetër bëhet përmes vlerësimit të vazhduar, si për shembull, në organizim të seminareve, detyrave të kursit në grup apo individuale, punëve të laboratorit, raporteve për praktikën profesionale etj. Në këtë mënyrë i jepet mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike. Për paqartësi të ndryshme ka dhe seanca konsultative. (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM;

	Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc Farmaci; Evidenca 50. Model testi për kontrollin e njohurive).			
Konkluzione	<i>KUR dhe FSHM kanë hartuar rregullore dhe procedura për mënyrat e testimit dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi i vlerësimit të studentëve realizohet si vlerësimi i vazhduar gjatë vitit, për elementët e përcaktuar në programin e modulit si seminare, laboratore, detyra kursi, teste paraprake etj. Vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë të vazhduar, vlerësohet frekuentimi 5%, përgatitja në seminare 5%, detyra e kursit 5%, provimi i pjesshëm 15%, provimi përfundimtar 70%. (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM; Evidenca 6. Rregullore e Programit MSc Farmaci; Evidenca 46. Syllabuset e programit të MSc Farmaci). Sipas “Rregullores së Programit të Studimit”, përcaktohen raportet mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar, gjë që reflektohet nga çdo titullar lënde në syllabuse.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni ka vendosur në zbatim sisteme, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. Në sallën e provimit janë instaluar kamera, të cilat bëjnë të mundur kontrollin e studentëve të cilët mund të kopjojnë. Tezat e provimit në të gjitha kontrollet hartohen nga titullari i lëndës. (Evidenca 10 Rregullore per Zhvillimin e Provimeve, Evidenca 15 Kodi i Etikes).
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet përmes testimit final si dhe vlerësimit të vazhduar (seminare, punë kursi, etj), në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Studentët informohen si në fillim të lëndës/modulit, ashtu edhe para provimit me mënyrën e vlerësimit përfundimtar dhe me peshën specifike të secilit aspekt të vlerësimit në vlerësimin final. (Evidenca 43. Programi mësimor i integruar i studimit Msc. Farmaci; Evidenca 46. Syllabuset e programit të MSc Farmaci).
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback	Vlerësimi i njohurive në testimin final rallë shoqërohet me komente, ndërsa gjatë vlerësimit të vazhduar të njohurive gjatë

(nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	vitit, pedagogu nxit diskutime dhe bën komente mbi çështjen në diskutim, jep këshilla dhe bën sqarime, për të ndihmuar studentin në procesin e të nxënit. (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM; Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc Farmaci; Evidenca 50. Model testi per kontrollin e njohurive te studenteve; Evidenca 51. Model testi i shoqëruar me komente).
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Gjatë hartimit të projekteve apo detyrave të kursit, studentët sqarohen si të shmangin plagjiaturën dhe si të referojnë apo citojnë burime të pavarura, <i>por nuk ka një program për kontrollin e plagjiaturës</i> . Studentët qartësohen që kopjimi në provime nuk tolerohet nga personeli akademik. Në provim mbahet procesverbal, në të cilin shënohen emrat e pjesëmarrësve me nënshkrimin e tyre, për pjesëmarrjen në provim. (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM; Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc Farmaci; Evidenca 10. Rregullore e zhvillimit të provimeve; Evidenca 15. Kodi i Etikes).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas takimit me studentët, stafin dhe bazuar në RVB, rezultati i kontrollit të njohurive bëhet sipas meritës së çdo studenti. Studenti ka të drejtën të ballafaqohet me vlerësimin dhe të informohet për mënyrën dhe shkallën e vlerësimit. Pas përfundimit të çdo provimi rezultatet bëhen të njohura brenda 3 ditëve nga dita e zhvillimit të tij. Rezultatet e kontrollit të dijeve jepen në kohë në zbatim të rregulloreve përkatëse. (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM; Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc Farmaci; Evidenca 10. Rregullore e zhvillimit të provimeve; Evidenca 15. Kodi i Etikes).
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas takimit me studentët dhe stafin, çdo student njihet me vlerësimin dhe ka të drejtën e rishikimit të vlerësimit bazuar në rregulloren dhe procedurat e vlerësimit. Secili pedagog organizon seanca konsultative dhe sqaruese me studentët në lidhje me vlerësimin e shpallur. Pas ballafaqimeve, pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet përfundimtare të studentëve. Në rast se studenti ka vërejtje për vlerësimin edhe pas ballafaqimit, studenti ankimon vlerësimin dhe ngrihet nje komision nga njësia bazë për rikontrollim prapë testi, ashtu sic është parashikuar në rregulloren e provimeve. (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM; Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc Farmaci; Evidenca 10. Rregullore e zhvillimit të provimeve; Evidenca 15. Kodi i Etikes).
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.	Për çdo kërkesë apo ankimim të rezultatit, studenti paraqet kërkesën me shkrim pranë Departamentit, i cili sipas rregullores,

Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	ngre një komision rivlerësimi të rezultatit. Rivlerësimi dokumentohet në mënyrë transparente dhe arkivohet. (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM; Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc Farmaci). Deri tani, nuk ka patur kërkesë, ankimim, nga studentët në lidhje me vlerësimin që të shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit. Vlerësimi kryesor bëhet me testim me shkrim, duke ja bashkangjitur vlerësimit të vazhduar të njohurive që bëhet gjatë gjithë procesit mësimor, si p.sh. organizimi i seminareve, detyrave të kursit në grup apo individuale, punëve të laboratorit, raporteve për praktikat profesionale etj. Në këtë mënyrë i jepet mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Nga takimi me departamentin, dhe bazuar në evidencat, programi i studimit është i organizuar që studentit t'i ofrohen njohuritë bazë teorike dhe praktike për t'u formuar dhe zhvilluar profesionalisht në fushën farmaceutike me objektiv kryesor formimin e specialistëve në këtë fushë, të aftë për të punuar si farmacist dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë. (Evidenca 6. Rregullore e Programit MSc Farmaci; Evidenca 44 Plani mësimor i programit të studimit Msc Farmaci). Ky program përfshin lëndë dhe module, të cilat në tërësinë e tyre garantojnë zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. (Evidenca 43. Programi mësimor; Evidenca 46. Syllabuset e programit të MSc Farmaci).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, përmes syllabuseve të hartuara me kujdes për këtë qëllim, sidomos përmes lëndëve Biostatistikë dhe informatikë, psikologji komunikimi, latinisht e anglisht. (Evidenca 43. Programi mësimor; Evidenca 44. Plani mësimor i programit të studimit Msc Farmaci; Evidenca 46. Syllabuset e programit të MSc Farmaci).



Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.	Duke u bazuar në Rregulloren e departamentit, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen dhe shqyrtohen në përfundim të lëndës (Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc Farmaci). Nga takimet vumë re se në disa raste organizohen mbledhje departamenti të veçanta, por edhe sondazhe, anketime dhe biseda me studentët, ku diskutohen çështjet më të rëndësishme të modulit, orientohen studentët dhe ju sqarohen atyre detyrimet përmblylëse. Programet rishikohen periodikisht çdo vit, në përshtatje me nevojat e tregut. Këto programe studimi rishikohen, në mënyrë që të mbështeten në rezultatet e të nxënësve. IAL ka udhëzime për punimin e diplomës. (Evidenca nr. 19: Udhëzues për punimin e diplomës). Staf i pedagogëve, udhëheqësit e temave të diplomave, organizojnë takime rutinë me studentët e vitit të pestë për t'i udhëzuar dhe drejtuar në realizimin e diplomave.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikë profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi i integruar i studimit përfshin orët e laboratorit dhe praktikës profesionale. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra gjatë këtyre orëve. (Evidenca 95. Infrastruktura akademike në funksion të programit Msc. Farmaci). Në projekte apo detyra në grup, personeli akademik nxit dhe mbështet diskutimet dhe debatet për gjetjen e zgjidhjes të problemeve të ndryshme. KUR/ FSHM/ DF ka marrëveshje bashkëpunimi me farmaci, ku studentët kryejnë praktika profesionale duke mundësuar zbatimin konkret të njohurive dhe rritur mobilitetet e tyre. (Evidenca 29. Lista e farmacive me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikës profesionale). Në funksion të programeve të studimit të ofruara, institucioni ka një sërë laboratorësh mësimorë. (Evidenca 96. Laboratorët në IAL) Laboratorët janë të pajisur me aparaturë dhe mjete mësimore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike. Personeli akademik bashkëpunon me drejtuesit e institucioneve apo kompanive, për zhvillimin e praktikave mësimore (Evidenca 20. Libri i zhvillimit të praktikës profesionale).
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga takimet me personelin akademik dhe dokumentacioni, u evidentua se stafi organizon orë të hapura leksioni apo seminare, konferenca shkencore dhe ëorkshop-e, (Evidenca 85. Leksion i hapur "Profesionet e rregulluara dhe procedura ligjore për marrjen e licencës së ushtrimit të profesionit"; Evidenca 87. Leksion i hapur "Mbrotjtja e jetës dhe e shëndetit"; Evidenca 88. Leksion i hapur "Tetori rozë"; Evidenca 84, Seminar ndërkombëtar "Sustainable Coopetation Between Italian and

	<i>Albanian Academic Contexts. Which instruments from EU?”), gjatë të cilave diskutohet mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë, si brenda ashtu edhe jashtë strukturës së programit të studimit. (Evidenca 116. Kontratë pune-tip;).</i>		
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga takimi me NJSBC dhe stafin akademik, KUR mbështet punimet kërkimore shkencore, të cilat botohen falas. (Evidenca 35. Vendim i BA per miratim fondi per Kerkimin Shkencor; Evidenca 36. Vendim i BA për miratim fondi për Këshillin Studentor). Bordi i Administrimit të IAL çdo vit ka miratuar fond të veçantë për mbështetjen e studentëve.		
Konkluzione	<i>Programi i studimit, përmes disiplinave të ndryshme, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët. Në të njëjtën kohë ky program synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ata, në përputhje dhe me strategjinë e institucionit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në bazë të rregulloreve, KUR dhe FSHM, kanë hartuar procedura të posaçme për detyrimet përmbyllëse, përmes mbrojtjes së tezës së diplomës. Datat e mbrojtjes së tezës së diplomës dhe çdo informacion tjetër që lidhet me to, ju komunikohen paraprakisht studentëve si dhe afishohen në ambiente të posaçme. Këto procedura janë publike dhe gjenden edhe në faqen e KUR në rubrikën “Legjislacioni”. https://unireal.edu.al/legjislacioni/ (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM; Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc Farmaci; Evidenca 11. Rregullore e diplomimit). Sipas RVB, shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe çdo detyrimi tjetër financiar kundrejt Kolegjit, është kusht paraprak për kryerjes e mbrojtjes së tezës së diplomës.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Duke u bazuar në rregulloret, Departamenti i Farmacisë, si struktura përgjegjëse për këtë program studimi, dhe personeli akademik, i njeh studentët me mënyrën e përgatitjes së tezës së diplomës, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të këtij detyrimi përmbyllës (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM; Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc Farmaci;

	Evidenca 19. Udhëzim për punimin e diplomës). Studentët kanë mundësi të marrin në faqen e KUR të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me programin e studimit, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, orarin mësimor, kalendarin e provimeve, etj. https://unireald.edu.al/studentet/
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Departamenti cakton komisionin e posaçëm, që miratohet nga dekani i FSHM-së, për administrimin e mbrojtjes së diplomës. (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM; Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc Farmaci; Evidenca 11. Rregullore e diplomimit). Procedura e mbrojtjes së diplomës përfshin një prezantim nga studenti, ku ai përmbledh punën e kryer, rezultatet e studimit, përfundimet, me pyetje dhe përgjigje.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Nga departamenti u njohëm se diplomimi i studentëve në këtë program studimi, bëhet me mbrojtje të tezës së diplomës, ku studenti hyn pasi ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj lëndëve të përfshira në program. (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 11. Rregullore e diplomimit). Nga takimi me stafin, studentët dhe nga RVB, rezulton se, me pedagogun udhëheqës, studenti harton platformën e punimit, fazat e realizimit të tij. Në çdo rast studenti mbikëqyret nga udhëheqësi, i cili i ofron ndihmë, e orienton, i bën vërejtje, e udhëzon deri në realizimin përfundimtar të punimit. Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, interpretimin e tyre, si dhe konkluzionet përmbyllëse sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e punës se kryer nga studenti diplomant dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit të vlerësimit të punimit të Diplomës.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni, përmes stafit akademik të Departamentit të Farmacisë, asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij, si dhe mjedise të tjera si biblioteka e IAL, në funksion të përgatitjes së temës së diplomës nga studenti. (Evidenca 96. Labororet në IAL; Evidenca 98. Lista e librave në fushën e farmacie që ndodhen në bibliotekën e IAL).
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi me notë i studentit në përfundim të mbrojtjes së diplomës, është e parashikuar nga aktet e brendshme të institucionit. (Evidenca 4. Rregullore e IAL; Evidenca 5. Rregullore e FSHM; Evidenca 6: Rregullore e Programit MSc

	Farmaci; Evidenca 11. Rregullore e diplomimit; Evidenca 53. Model i punimit të diplomës).			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, në përfundim të studimeve në programin e studimit MSc “Farmaci” (Evidenca 2. Statuti i IAL, Evidenca 4. Rregullore e studimeve të KUR). Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopja e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar (Evidenca 54. Modeli i diplomës; Evidenca 55. Modeli i listës së notave; Evidencë 56. Modeli i suplementit të diplomës; Evidenca 43. Programi i studimit).			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, KUR/FSHM, ruan kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. IAL ka ndërtuar program elektronik për ruajtjen e të dhënave dhe dokumentacionin e studentit në dy gjuhë, shqipe dhe italiane. Dokumentacioni i studentit ruhet në formatin elektronik dhe në hardcopy. (Evidenca 103. Database për ruajtjen e të dhënave të dhënave dhe dokumentacionin e studentëve në rrugë elektronike (në gjuhën shqipe); Evidenca 104. Database për ruajtjen e të dhënave të dhënave dhe dokumentacionin e studentëve në rrugë elektronike (në gjuhën italiane)).			
Konkluzione	<i>Në bazë të rregulloreve, Institucioni ndjek një procedure të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe në pajisjen e studentit me dokumentacionin përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky standard nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe	

teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitim të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1								
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.								
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve							
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Dokumentacioni i çdo punonjësi ruhet në arkivën e Sektorit të Burimeve Njerëzore. Dosjet e personelit përditësohen vazhdimisht me aktivitete të reja të stafit, rezultate të kërkimit apo kualifikime (Evidenca nr. 41. Staf akademik i njësise bazë; Evidenca nr. 48. Te dhëna mbi stafit akademik MSc. në Farmaci ne 3 vitet e fundit; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 3. Lista e stafit akademik te DF dhe stafi i angazhuar në programin e studimit Msc. Farmaci - viti akademik 2022-2023).							
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përgjatë viteve, paraqitet si në vijim:							
	<table><tr><th>Viti akademik</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>22-23</td><td>18 PAE me kualifikimin: 2</td><td>4 PAK me kualifikimin: 1</td></tr></table>	Viti akademik	PAE	PAK	22-23	18 PAE me kualifikimin: 2	4 PAK me kualifikimin: 1	
Viti akademik	PAE	PAK						
22-23	18 PAE me kualifikimin: 2	4 PAK me kualifikimin: 1						

		Prof.Dr., 6 Dr., 1 SPA, 9 Msc.	Prof.As., 1 Dr., 2 Msc.
	21-22	19 PAE me kualifikimin: 3 Prof.Dr., 1 Prof.As., 5 Dr., 2 SPA, 8 Msc.	2 PAK me kualifikimin: 1 Prof.As., 1 Msc.
	20-21	18 PAE me kualifikimin: 3 Prof.Dr., 2 Prof.As., 5 Dr., 2 SPA, 6 Msc.	4 PAK me kualifikimin: 2 Prof.As., 1 Dr., 1 Msc.
	19-20	16 PAE me kualifikimin: 3 Prof.Dr., 2 Prof.As., 4 Dr., 1 SPA, 6 Msc.	4 PAK me kualifikimin: 2 Prof.As., 1 Dr., 1 Msc.
	18-19	17 PAE me kualifikimin: 3 Prof.Dr., 2 Prof.As., 5 Dr., 1 SPA, 6 Msc.	3 PAK me kualifikimin: 1 Prof.As., 1 Dr., 1 Msc.
	Sikurse evidentohet nga të dhënat e paraqitura më lart, në të gjitha këto vite akademike, <i>institucioni ka angazhuar në mësimdhënie personel akademik jo me grada/tituj, sikurse kërkohet nga legjislacioni në fuqi.</i> Neni 59, pika 6 e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, parashikon se: "<i>Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës</i>". Përsa i përket titullarëve të lëndëve, nga dokumentacioni i dorëzuar (syllabuset/plani i lidhur me stafin) evidentohet <i>se jo të gjithë titullarët e lëndëve janë të kategorisë "Profesor", sikurse kërkohet nga pika 3 e nenit 59 të LAL 80/2015.</i> Përsa i përket ngarkesës mësimore, mbulimi i ngarkesës nga personeli akademik, përgjatë viteve akademike, rezulton si në vijim: - Viti akademik 19-20: 92.16% PAE / 7.84% PAK; - Viti akademik 20-21: 92.8% PAE / 7.2% PAK; - Viti akademik 21-22: 96.7% PAE / 3.3% PAK; - Viti akademik 22-23: 86.59% PAE / 13.41% PAK; Sikurse evidentohet nga më lart, personeli akademik mbulon ngarkesën mësimore sipas kornizës ligjore në fuqi.		

	Nga shqyrtimi i të dhënave të paraqitura nga institucioni, evidentohet se tek plani mësimor i lidhur me stafin e programit dhe tabelat e stafit akademik i angazhuar në programin e studimit <i>ka disa mospërputhje</i>, pasi evidentohen emra të stafit akademik që janë angazhuar në lëndë të caktuara në program sipas tabelës, apo emra të stafit që janë përfshirë në tabelën e stafit të programit të studimit por nuk mbulojnë asnjë lëndë sipas tabelës së planit të lidhur me stafin. Në vijim po vendosim për referencë disa prej mospërputhjeve: 1. Tek tabela e planit të lidhur me stafin, 19-20, Dr. E.P është PAK, ndërkohë që tek stafi akademik i programit nuk është përfshirë fare, ndaj është llogaritur si PAK si në tabelën e parë; 2. Tek tabela e planit të lidhur me stafin, 19-20, M.Xh është vënë 1 herë PAE dhe 1 herë PAK, ndërkohë që tek tabela e stafit të programit është PAE, ndaj është llogaritur si i tillë; 3. Tek tabela e planit të lidhur me stafin, 20-21, E.P, M.Xh, E.H janë vënë gabim si PAK, ndërkohë që tek tabela e stafit të programit janë PAE, ndaj do të llogariten si PAE. 4. Tek tabela e stafit të programit 20-21 anëtari G.S, nuk mbulon asnjë lëndë tek tabela e planit të lidhur me stafin, etj. GVJ thekson se, në pasqyrimin e të dhënave sa më lart, për stafin akademik të angazhuar në program për vitet akademike 17-22 i është referuar tabelave 6.1 deri 6.4 të tabelave përmbledhëse, ndërsa për llogaritjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik për vitet 19-22 i është referuar tabelave në evidencën 45, ngarkesa mësimore vjetore. Për vitin akademik 22-23, GVJ i është referuar evidencës shtesë të marrë gjatë vizitës në institucion.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Qëndrueshmëria e personelit akademik është e kërcënuar nga largimet e vazhdueshme për shkak të emigracionit (diskutuar edhe gjatë vizitës në institucion). <i>KUR edhe pse ndjek politikë për të qënë konkurues dhe tërheqës si IAL për burime njerëzore cilësore duke investuar në rritjen profesionale gjatë viteve, ka jo qëndrueshmëri në staf akademik me kohë të plotë.</i> Mundësi zgjidhje të jetëgjatësisë dhe kualifikimeve të stafit duhet të konsiderohen me prioritet. Punësimi i personelit në KUR respekton kërkesat e Kodit të Punës, me kontrata individuale punësimi dhe mbulimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 3. Lista e stafit akademik të DF dhe stafi i angazhuar në programin e studimit Msc. Farmaci - viti akademik 2022-2023; Evidenca 116. Kontrata pune e personelit akademik Tip, me kohe të plote dhe kohe të pjesshme).

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	KUR në përputhje me afatet kohore ngre komisionet ad-hoc të vlerësimit me 5 anëtarë nga të cilët 3 janë përfaqësues të Departamentit përkatës, një përfaqësues i Dekanatit dhe një përfaqësues i Rektoratit (Evidenca 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD; Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme). Komisioni bën vlerësimin e aplikantëve në përputhje me kriteret e shpallura, shqyrton dosjen e aplikimit sipas formularit të vlerësimit dhe harton listën e kandidaturave, sipas pikëve të grumbulluara, në rendin zbritës për çdo kandidat së bashku me pikët e intervistës. Kandidatët njoftohen nga NJSBC me email për pikët e grumbulluara dhe rankimin e tyre. Shpallet lista përfundimtare e kandidatëve fitues nga Dekani, i cili përcjell tek Rektori emrat fitues, së bashku me renditjen e tyre. (Evidenca 47. Praktike rekrutimi staf akademik 2022-2023)
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	KUR garanton mbarëvajtjen e praktikave mësimore (laboratoreve) në ambiente adekuate dhe me personelin e duhur akademik. (Vizita në institucion).
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	IAL përditëson çdo vit të dhënat e personelit akademik, ndihmës dhe administrativ. Përditësimi i të dhënave realizohet nga zyra e burimeve njerëzore ku çdo staf ka dosjen personale dhe përveç zyrës së burimeve njerëzore njësi bazë, departamenti zotëron dosje të stafit akademik si modulet ku janë të angazhuar, ngarkesën dhe shpërndarjen e saj sikurse edhe materialet ndihmëse për zhvillimin e moduleve përkatëse. <i>Nga dosjet e personelit akademik të përzgjedhur në mënyrë rastësore që u shqyrtoan gjatë vizitës, u evidentuan disa mospërputhje/problematika si në vijim:</i> - Raste ku kontratat e personelit akademik nuk ishin sipas legjislacionit në fuqi lidhur me kohëzgjatjen e kontratës, pasi psh. kishte raste ku personeli akademik me titullin Prof. As. kishte kontratë të lidhur me afat të caktuar 1 vjeçar, ndërkohë që sipas legjislacionit duhet të ketë kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar; - Kontratat e personelit akademik, nga ana e KUR, ishin të firmosura nga Kryetari i Bordit të Administrimit dhe jo nga Rektori, sikurse kërkuar nga LAL 80/2015; - Personeli PAK nuk kishte në dosje lejen nga punëdhënësi. <i>Për sa më lart, gjetjet e GVJ duhen analizuar dhe konfuzioni në dokumentacion duhet të plotësohet dhe të saktësohet.</i>

	(Evidenca 48. Te dhena mbi stafit akademik MSc. në Farmaci ne 3 vitet e fundit; Evidenca shtesë gjatë vizitës nr. 3. Lista e stafit akademik te DF dhe stafi i angazhuar ne programin e studimit Msc. Farmaci - viti akademik 2022-2023; Vizita në institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore).
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Bazuar në marrëveshjet që KUR ka me IAL të tjera publike dhe private por edhe biznese si farmaci vendos në dispozicion stafin e mjaftueshëm për të udhëhequr dhe mbikëqyrur praktikatat profesionale (sipas librit të praktikës profesionale të studentit). Punimi i diplomave është një kombinim i nevojave të sektorit për studime specifike dhe bashkë propozimeve student-pedagog. Gjate vizitës në institucion në intervistat me stafin akademik por edhe studentet e vitit të fundit pyetjeve rreth zhvillimit të temave të diplomave nga propozimi deri në mbrojtjen e tyre, kuptojmë se <i>temat përbëjnë kryesisht rishikime të literaturës dhe përpunim të dhënash statistikore sesa hulumtime të mirëfillta shkencore me bazë eksperimentale. GVJ gjykon se temave studimore me baza eksperimentale u duhen dhënë përparësi, mangësi e këtij programi.</i> (Evidenca 20. Libri i praktikës profesionale Msc. Farmaci; Evidenca 25. Lista e IAL-ve me të cilat KUR ka marrëveshje bashkëpunimi; Evidenca 29. Lista e farmacive me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikës profesionale).
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Personeli mbikëqyrës në farmacinë pritëse angazhohet dhe kontribuon në mënyrë aktive në plotësimin e librit të praktikës profesionale të studentit si një raport përfundimtar. Praktika profesionale vlerësohet me notë nga komisioni i provimit. (Evidenca 20. Libri i praktikës profesionale Msc. Farmaci).
Konkluzione	<i>KUR ka angazhuar në mësimdhënie personel akademik jo me grada/tituj, sikurse kërkohet nga legjislacioni në fuqi, përkatësisht neni 59, pika 6 e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Gjithashtu, evidentohet se jo të gjithë titullarët e lëndëve janë të kategorisë "Profesor", sikurse kërkohet nga pika 3 e nenit 59 të LAL 80/2015. Personeli akademik me kohë të plotë, i angazhuar në këtë program studimi, mbulon mbi 70% të ngarkesës së përgjithshme të programit. KUR edhe pse ndjek politikë për të qënë konkurues dhe tërheqës si IAL për burime njerëzore cilësore duke investuar në rritjen</i>

	profesionale gjatë viteve, ka jo qëndrueshmëri në staf akademik me kohë të plotë. Nga dosjet e personelit akademik të përzgjedhur në mënyrë rastësore që u shqyrtuan gjatë vizitës, u evidentuan disa mospërputhje/problematika, për të cilat IAL duhet të marrë masa të plotësojë/korrigjojë. Temat e diplomave të studentëve përbëjnë kryesisht rishikime të literaturës dhe përpunim të dhënash statistikore sesa hulumtime të mirëfillta shkencore me bazë eksperimentale. GVJ gjykon se temave studimore me baza eksperimentale u duhen dhënë përparësi, mangësi e këtij programi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	KUR kryen dhe zhvillon veprimtarinë akademike dhe administrative në mjedis bashkëkohor të përshtatshëm për pjesën administrative, atë akademike dhe atë mbështetëse sipas natyrës specifike të moduleve përkatëse. Mjediset janë ekskluzivisht të dedikuara aktiviteteve specifike. (Evidenca 95. Infrastruktura akademike në funksion të programit Msc. Farmaci ; Evidenca 96 Labororet ne IAL ; Evidenca 97. Rack-u i lidhjes në rrjet dhe Laboratori i Informatikës ne IAL).
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	KUR disponon infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të tij. Ambientet e fakulteteve (salla leksionesh e seminaresh, laboratorë didaktikë mësimorë) janë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor e kërkimor-shkencor për studentët dhe personelin akademik. Sipërfaqet në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve për kryerjen e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, janë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. (Evidenca 91. Raporti vjetor i Kerkimit Shkencor per vitin akademik 2021-2022 ; Evidenca 92. Raporti vjetor 2021-2022 dhe shkresa percjellese ne MAS ; Evidenca 95. Infrastruktura akademike në funksion të programit Msc. Farmaci ; Evidenca 97. Rack-u i lidhjes në rrjet dhe Laboratori i Informatikës ne IAL).
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit.	Në nivel programi studimi, të gjithë laboratorët ku zhvillohen orët laboratorike janë të pajisur dhe plotësuar me mjete mësimore,



përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	aparatura dhe reagentë në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit. (Vizita në institucion, ambjentet e IAL).			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	KUR ka një laborator të informatikës të pajisur me kompjutera dhe akses në programe dhe databaza specifike në dispozicion të studentëve dhe stafit. (Evidenca 97. Rack-u i lidhjes në rrjet dhe Laboratori i Informatikës në IAL).			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Duke u bazuar në evidencën në dispozicion, GVJ konkludon se mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. (Evidenca 25. Lista e IAL-ve me të cilat KUR ka marrëveshje bashkëpunimi; Evidenca 95. Infrastruktura akademike në funksion të programit Msc. Farmaci).			
Konkluzione	Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga vizita në IAL u konstatua se KUR në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme për profilin e programit të integruar Master i Shkencave në Farmaci.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ajo mbështetëse qoftë fizike dhe ajo digjitale janë të garantuara për mbarëvajtjen e programit të studimit. Literatura e përdorur për pjesën më të madhe të moduleve është literaturë e vjetër e profesorëve të njohur nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe nga Departamenti i Farmacisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. Literatura në formë cikël leksionesh rishikohet dhe përditësohet cdo fillim viti akademik deri në masën 10%. (Evidenca 98. Lista e librave në fushën e



	farmacise qe ndodhen ne biblioteken e IAL; Evidenca 100. Biblioteka online dhe lista e librave te disponueshem).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Çdo vit KUR parashikon një buxhet të caktuar për blerjen e librave dhe pasurimin e bibliotekës. Kërkesat nisin nga departamentet për botimet e reja, revista etj. <i>GVJ konstaton se përditësimet në literaturë nuk rezultojnë të jenë të realizuara për të gjithë lëndët e programit të farmacistë.</i> (Evidenca 46. Syllabuset e programit MSc. Farmaci; Evidenca 98. Lista e librave ne fushen e farmacise qe ndodhen ne biblioteken e IAL).
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Të gjithë studentët kanë akses të plotë në bibliotekën online, ky akses ju jepet që në momentin e parë që ata janë studentë. (Vizita në institucion, ambjentet e IAL).
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifíkës së programit të studimit.	Literatura fizike garanton mbulimin e të gjitha moduleve dhe veprimtarisë specifike të programit. Bashkëpunimet me IAL ndërkombëtare duhet t'u kërkohej edhe donacioni me literaturë për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës në KUR. (Evidenca 98. Lista e librave ne fushen e farmacise qe ndodhen ne biblioteken e IAL).
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Shfrytëzimi i bibliotekës fizike dhe online është i garantuar në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët dhe stafin. (Evidenca 100. Biblioteka online dhe lista e librave te disponueshem).
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike të aksesueshme nga studentët dhe stafi i KUR. (Vizita në institucion, ambjentet e IAL).
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ka orare të përshtatëshme për studentët. Oraret janë të afishuara në bibliotekë. Studentët kanë mundësi aksesimi në bibliotekë edhe ditën e shtunë. <i>GVJ sugjeron se biblioteka duhet të ofrojë orare ekstra gjatë kohës së sezoneve të provimeve.</i> (Evidenca 100. Biblioteka online dhe lista e librave te disponueshem).

Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Njësia përgjegjëse e programit ndjek cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit. Kjo shërben për saktësimin e nevojave të literaturës së nevojshme për studentët dhe stafin e programit mësimor Farmaci. (Evidenca 98. Lista e librave në fushën e farmaceutikës që ndodhen në bibliotekën e IAL; Evidenca 100. Biblioteka online dhe lista e librave të disponueshëm).			
Konkluzione	<i>Programi i integruar i studimit MSH në Farmaci përmban literaturën e nevojshme në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme). Literatura bazë dhe ajo mbështetëse qoftë fizike dhe ajo digjitale janë të garantuara për mbarrëvajtjen e programit të studimit. Më shumë vëmendje i duhet dedikuar përditësimit të literaturës nga titullarët e lëndëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	KUR disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Të dhënat e studentëve dhe dokumentacioni i tyre, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, dhe këto administrohen nga sekretaria mësimore e IAL, sipas një procedure të miratuar. Gjithashtu, KUR ka databazë për ruajtjen në formatin elektronik të të dhënave të studentëve (në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane), ku përfshihen gjeneralitetet, dokumentacioni i shkollës së mesme, data e regjistrimit, programi i studimit, matrikullimi, numri i telefonit, e-maili, nr. ID, gjendja civile, vendlindja, vendbanimi, foto e studentit, pagesat, etj). (Evidenca 12. Rregulloret e Sekretarisë në KUR; Evidenca 103. Database për ruajtjen e të dhënave dhe

	dokumentave te studenteve ne rruge elektronike - ne gjuhen shqipe; Evidenca 104. Database per ruajtjen e te dhenave dhe dokumentave te studenteve ne rruge elektronike- ne gjuhe te huaj).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Të dhënat dhe dokumentacioni për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore. Dokumentacioni arshivohet dhe ruhet në arkivën e IAL. KUR ka miratuar Rregulloren për "Mbrotjtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale". (Evidenca 13. Rregullore per Mbrotjtjen Përpunimin Ruajtjen dhe Sigurine e te Dhenave Personale – 2020).
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për personelin dhe studentët e programit të studimit. Dokumentacioni administrohet sipas një procedure standarde. KUR ka hartuar Rregulloren e standardizimit të procedurave për hartimin, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar (në formë elektronike apo në letër), e cila është miratuar me Vendimin nr. 36, datë 01.06.2020, të Senatit Akademik. (Evidenca 14. Rregullore e standardizimit te pracedurave per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve – 2020; Evidenca 37. Vendim nr. 36 dt.01.06.2020 i Senatit Akademik).
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Stafi akademik, përveç komunikimit me e-mail dhe grupeve mësimore, përdor dhe platforma të edukimit si google education, classroom etj., me anën e të cilave shkëmbehen informacione dhe materiale me studentët. (Evidenca 105. Platforma pe komunikimin eletronic ne IAL).
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. (Evidenca 106. Foto e sistemit te informimit akademik ne kohe reale ne IAL).
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqa e web e KUR jep gjithë informacionin e detajuar për programin e studimit, stafin akademik përgjegjës, aktivitete etj. Faqja e web është e publikuar në tre gjuhë: Shqip, Anglisht dhe Italisht.
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se garantohet një sistem i brendshëm i menaxhimit institucional dhe është në dispozicion të administrimit, informimit</i>

	<i>dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	KUR harton çdo vit raportin financiar i cili realizohet nga zyra e financës së IAL. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Gjithashtu, Bordi i Administrimit miraton fond të veçantë për mbështetjen e aktiviteteve të studentëve, apo për aktivitete kërkimore shkencore të stafit. (Evidenca 2. Statuti KUR; Evidenca 112. Raport financiar mbi koston e programit të studimit Msc. Farmaci).
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Zyra e financës administron dokumentacionin financiar. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit përmban financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit. Evidentohet në dokumentacion detajimi në zëra specifik i të gjitha shpenzimeve dhe shërbimeve të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e programit të studimit. (Evidenca 2. Statuti KUR; Evidenca 113. Raport financiar vjetor i IAL per vitin 2021).
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	KUR kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Zyra e financës administron gjithë dokumentacionin financiar. (Evidenca 2. Statuti KUR; Evidenca 113. Raport financiar vjetor i IAL per vitin 2021).
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	KUR raporton, me periodicitet vjetor, në njësinë bazë mbi realizimin e buxhetit të vitit paraardhës por edhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës. (Evidenca 113. Raport financiar vjetor i IAL per vitin 2021).

Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Suksesi i vazhdueshëm në menaxhimin, drejtimin dhe diplomimin tregon për një qëndrueshmëri institucionale dhe financiare, <i>por më shumë duhet bërë për të arritur cilësinë që studentët të BE e kanë të garantuar. Fond i dedikuar për mbështetje të kërkimit shkencor duhet të jete në propozimet e çdo viti akademik në vazhdim.</i> (Evidenca 113. Raport financiar vjetor i IAL per vitin 2021).			
Konkluzione	KUR garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. Buxhet i dedikuar duhet të vendoset në dispozicion për kërkimin shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	KUR është përgjegjëse për përcaktimin e kriterëve përzgjedhëse në të gjitha programet e studimit që ofron dhe për këtë qëllim ka hartuar dhe zbaton një sërë aktesh rregullatorë (në Statutin dhe në Rregulloren e brendshme të IAL) si dhe zbaton të drejtat dhe detyrimet e studentëve përcaktohen bazuar në LAL nr. 80/2015. (Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL; Evidenca 36. Vendim i BA per miratim fondi per Këshillin Studentor).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	IAL, nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për studentë. (Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL; Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore).

Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet e integruar të ciklit të dytë në KUR bëhet në përputhje me kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga Senati Akademik para fillimit të vit akademik. Kriteret e veçanta hartohen nga njësia bazë çdo fillim viti akademik. Emrat e kandidatëve fitues dërgohen në QSHA dhe MAS, si dhe publikohen në faqen e KUR. (Evidenca 33. Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve).
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme dhe lehtësisht të kuptueshme pasi gjenden në faqen e web-it të KUR, si dhe në Rregulloren e përgjithshme të KUR. Politikat e pranimit të studentëve parashikohen edhe në programin e studimit. (Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL; Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore).
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	KUR, çdo vit organizon takime me masantët e shkollave të mesme, për ti informuar ata lidhur me programet e studimit, kriteret e hyrjes dhe tarifat e studimit. Në çdo fillim viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Informacioni është i aksesueshëm edhe në faqen e KUR. (Evidenca 67. Kalendari për informimin e nxënësve masantë; Evidenca 107. Poster për informimin e masantëve).
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Para fillimit të vitit akademik KUR parashikon kriteret dhe kuota për kandidatët me aftësi të veçanta apo të shtresave të marginalizuara (komuniteti rom dhe egjiptian). (Evidenca 68. Tabela e kuotave të pranimit të studentëve në vitin akademik 2022-2023).
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	KUR në rregulloren e programit ka parashikuar kriteret për pranimin e studentëve të huaj. Pranimi i studentëve të huaj bëhet me konkurim të organizuar nga KUR. Studenti i huaj duhet të zotërojë njohjen e gjuhës shqipe, e vërtetuar përmes testeve kombëtare. (Evidenca 5. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore; Evidenca 33. Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve).

Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	KUR ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, si komuniteti rom dhe egjiptian, studentët me aftësi të kufizuara apo studentët me prind me aftësi të kufizuara, duke parashikuar kuota pranimi në programet e studimit sipas kategorive të veçanta, si dhe duke ofruar bursa studimi. Për këtë kategori janë paracaktuar kriteret për përfitim të bursave deri në masën 100%. (Evidenca 38. Vendim i BA për trajtimin e studentëve me status të veçantë).			
Konkluzione	KUR siguron nëpërmjet evidencave se harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Informacioni në lidhje me kriteret e përparimit akademik të studentëve është i publikuar nëpërmjet akteve rregullative institucionale, por edhe nëpërmjet publikimit të vendimeve specifike në web-in e KUR. Gjithashtu, organizmat e këshillave studentorë shërbejnë për informimin e studentëve apo adresimin e problematikave të tyre në organet përkatëse. (Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL; Evidenca 6. Rregullore e programit).
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatorë, procedura të miratuara e të bëra publike. (Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në lidhje me mënyrën e vlerësimit studentët informohen në orën e parë të çdo lënde për peshën e secilit komponent vlerësimi, rregullore dhe mbarëvajtje provimi. (Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL; Evidenca 46. Syllabuset e programit MSc. Farmaci).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni publikon informacione në lidhje me mënyrën e punimit të tezës së diplomimit, duke përfshirë jo vetëm formatin e shkrimit por edhe udhëzime në lidhje me organizimin e përgjithshëm të saj. (Evidenca 19. Udhëzuesi për punimin e temes së diplomes). KUR organizon edhe trajnime të hapura në

	lidhje me shkrimin dhe prezantimin e temës së diplomës (Evidenca 6. Rregullore e programit; Evidenca 19. Udhezuesi per punimin e temes se diplomes).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Çdo fillim viti akademik KUR harton kalendarin përkatës dhe organizon vizita nëpër shkollat e mesme me nxënësit maturantë për t'i njohur ata me programet e studimit që ofron IAL. Kalendar i përcillet për dijeni Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar. Zyra e Zhvillimit të Karrierës në KUR organizon takime me maturantët për programet e studimit të KUR-it, shpërndan postera, përgjigjet për pyetjet që kanë të interesuarit. Spoteve publicitare janë gjithashtu një praktikë që KUR ndjek. (Evidenca 7. Rregullore e Keshillimit te Karrieres).			
Konkluzione	KUR vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ndryshimet eventuale në programin e studimit. (Evidenca 43. Programi mësimor i integruar i studimit Msc. Farmaci 2022-2023; Evidenca 44. Plani mësimor i programit te integruar Msc. ne Farmaci. 2022-2023).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Përveç syllabuseve të lëndëve/moduleve që u vihen në dispozicion studentëve nga pedagogët përkatës, ata informohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për literaturën dhe materiale të tjera që mund të shfrytëzohen në funksion të lëndës. (Evidenca 43. Programi mësimor i integruar i studimit Msc. Farmaci 2022-2023; Evidenca 44. Plani mësimor i programit te integruar Msc. ne Farmaci. 2022-2023; Evidenca 46. Syllabuset e programit MSc. Farmaci; Evidenca 6. Rregullore e programit; Evidenca 11. Rregullore e diplomimit; Evidenca 19. Udhezuesi per punimin e temes se diplomes).

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në nivel fakulteti apo universiteti, studentët informohen për çdo aspekt për të cilin ata janë të interesuar si p.sh. mbi mundësitë e mobilitetit nëpërmjet programeve të ndryshme, punësimin si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. ZKK në bashkëpunim me ALUMNI-n hartojnë periodikisht raporte në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar në KUR. Rezulton që të gjithë studentët e diplomuar në programin e studimit janë të punësuar (Evidenca 78. Te dhëna për punësimin e studentëve në 5 vitet e fundit).			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Orientimi dhe këshillimi i studentëve realizohet dhe nëpërmjet guidave informative. (Evidenca 43. Programi mësimor i integruar i studimit Msc. Farmaci 2022-2023; Evidenca 46. Syllabuset e programit MSc. Farmaci; Evidenca 57. Orari mesimor Msc. Farmaci; Evidenca 58. Kalendari akademik i KUR 2022-2023; Evidenca 59. Kalendari i provimeve Msc. Farmaci. Viti akademik 2021-2022; Evidenca 96. Labororetet ne IAL), të cilat janë të publikuara në formë dixhitale, në dispozicion të studentëve.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në nivel programi studimi është ngritur dhe funksionon tutoriati ku për çdo kurs studimi është caktuar një pedagog i departamentit për t'i asistuar studentët në problematika të ndryshme por dhe për ti informuar në lidhje me aktet rregullative dhe elemente të detajuar të programit të studimit.			
Konkluzione	<i>KUR siguron për studentët informacion e nevojshëm në lidhje me strukturën dhe organizimin e programit sikurse edhe nëpërmjet këshillimit të karrierës aftëson studentët me mundësitë në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Në KUR arkiva përbëhet nga dokumentacioni i plotë i dosjeve me të dhënat e studentëve që nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi i tyre, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë në zyrat e sekretarive mësimore të secilit fakultet. (Evidenca 66. Te dhëna për nr. studenteve të diplomuar në 5 vitet e fundit). Sekretaret dhe arkivistët mbajnë regjistrin e diplomave të lëshuara.

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaret mbajnë regjistrin e regjistrimeve për çdo program studimi, regjistrin e diplomave të lëshuara, dosje personale të studentëve, dokumentacion të procedurave të transferimit apo çregjistrimit, procesverbale të provimeve, urdhra, udhëzime të ministrisë apo të organeve drejtuese të universitetit, etj. <i>Nga shqyrtimi i regjistrave gjatë vizitës në institucion u evidentuan disa mospërputhje/mangësi si në vijim:</i> 1. Regjistri themeltar nuk është sipas formatit të QSHA. IAL ka bërë kërkesë për pajisjen me regjistër por ende nuk i është vënë në dispozicion; 2. Regjistri themeltar në mbyllje të vitit akademik, tek viza nuk është vendosur shënimi “mbyllur me nr. rendor...” dhe nuk është firmosur; 3. Tek regjistri themeltar, në vitin akademik 19-20, për 2 studente të papajisura ende me numër matrikullimi, u konfirmua nga IAL gjatë vizitës se janë çregjistruar, por në regjistrin themeltar nuk figurojnë të plotësuarat të dhënat për çregjistrimin e tyre; 4. Tek regjistri themeltar, në vitin akademik 22-23, renditja e regjistrimit të studentëve sipas datës së regjistrimit nuk është e saktë dhe nuk rezultojnë të jetë mbajtur procesverbal për këtë pasaktësi; 5. Nga verifikimi i një procesverbali lëndeje dhe regjistrin themeltar, u evidentua se një studente është përfshirë në procesverbalin e lëndës, por nuk figuron e regjistruar në Regjistrin themeltar. Sipas deklaratimit të IAL-së gjatë vizitës nuk është përfshirë pasi nuk ka frekuentuar; 6. Në një rast transferimi të studimeve pranë KUR, nuk përputhet datat e çregjistrimit dhe regjistrimit në KUR, pasi vërtetimi i çregjistrimit nga IAL mban datën 14.10.2022, ndërsa regjistrimi në KUR, sipas regjistrin themeltar, është bërë më datë 07.10.2022, pra përpara çregjistrimit nga IAL që është transferuar; 7. Nga shqyrtimi i dosjeve të studentëve, evidentohet se kontrata e studentit nuk është firmosur nga KUR; 8. Regjistrimi i studentëve në regjistrin e diplomave nuk është bërë sipas datës së diplomimit dhe nuk janë plotësuar të gjitha të dhënat e numrave të diplomës. <i>Të gjitha këto gjetje duhet të adresohen dhe gabimi njerëzor të shmanget duke verifikuar në mënyrë të vazhdueshme dokumentacionin dhe të sigurohet se po respektohen gjithë procedurat sipas ligjit në fuqi.</i> Konfuzioni i hasur në sekretari duhet shmangur me plotësimin e regjistrave në mënyrë të saktë sipas dokumentacionit mbështetës dhe shtimi i stafit për atë zyrë e cila dokumenton materiale të konsiderueshme dhe voluminoze
--	--

	duhet konsideruar me përparësi. (Evidenca 60. Numri i studenteve të regjistruar, larguar, në 5 vitet e fundit, në programin Msc. Farmaci; Evidenca 61. Lista e studentëve në programin e integruar Msc. në Farmaci, viti akademik 2022-2023; Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore).
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të gjitha të dhënat e studentëve administrohen nga sekretaria mësimore e KUR. Autorizimi i të dhënave jepet nga titullari i institucionit, në përputhje me rregulloren përkatëse. (Evidenca 13. Rregullore për Mbrojtjen Perpunimin Ruajtjen dhe Sigurine e të Dhenave Personale – 2020; Evidenca 14. Rregullore e standardizimit të procedurave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve – 2020; Evidenca 62. Regjistri i studenteve. Amza - MSc. në Farmaci; Evidenca 63. Regjistër i arritjeve akademike të studenteve në programin MSc. në Farmaci; Evidenca 64. Regjister për lëshimin e diplomave - MSc. në Farmaci; Evidenca 103. Database për ruajtjen e të dhënave dhe dokumentave të studenteve në rrugë elektronike - në gjuhën shqipe).
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e universitetit dhe të arkivës. (Evidenca 13. Rregullore për Mbrojtjen Perpunimin Ruajtjen dhe Sigurine e të Dhenave Personale – 2020; Evidenca 14. Rregullore e standardizimit të procedurave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve – 2020). I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm. Për dokumente zyrtare, si procesverbale notash, vërtetime, ato gjenerohen vetëm nga persona të autorizuar dhe në një periudhë të caktuar kohe. Më pas këto dokumente janë unike dhe të patjetërsueshme. Sipas deklaratave gjatë vizitës në institucion KUR dhe Departamenti realizojnë kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin sipas akteve të nxjerra nga KUR (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre. Gjetjet e GVJ (kriteri 2) nuk ishin konstatuar gjatë kontrolleve periodike që institucioni kryen.

Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstaton se DF në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Karrierës harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Këto të dhëna pasqyrohen edhe në raportin vjetor që paraqet zyra e NJSBC. (Evidenca 65. Te dhëna për cilesine ne hyrje-dalje te studenteve ne programin Msc. Farmaci; Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC; Evidenca 78. Te dhëna për punesimin e studenteve ne 5 vitet e fundit).			
Konkluzione	<i>KUR mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Parregullsitë e përshkruara në kriterin 2 lidhur me regjistrat dhe dosjet e studentëve, duhen adresuar dhe GVJ sugjeron që kontrolli i brendshëm i institucionit të jetë efektiv në shqyrtimin e dokumentacionit dhe shmangien e gabimeve qofshin ato njerëzore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Përfaqësimi i studentëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe administrimit të UMT është garantuar në Statut dhe aktet rregullatorë të institucionit dhe fakulteteve. Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të universitetit, siç janë Senati Akademik dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në komisionet ad-hoc të ngritura në kuadër të vlerësimeve dhe analizave në nivel institucional dhe programi. (Evidenca 2. Statuti KUR; Evidenca 9. Rregullore NJSBC; Evidenca 75. Urdher për ngritjen e grupit të punës për zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studenteve).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Këshilli studentor është organ kolegjial përfaqësuesit e të cilit janë të zgjedhur nga vetë studentët. Në këtë kuadër, komunikimi institucional me këto organe përveçse një detyrim ligjor është edhe një mënyrë e drejtpërdrejtë për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të	Ndër strukturat pjesë e KUR në përmirësimin e programit të studimit janë edhe <i>Studentët aktualë</i> në programin e studimit, të cilët japin mendimin dhe propozimin e tyre për programin e

studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	studimit. Ata janë të organizuar me përfaqësuesit e tyre “senator” në nivel kursi por edhe në nivel programi studimi të cilët nëpërmjet Këshillit Studentor të FM mund të përcjellin mendimet e tyre jo vetëm në Dekanat, por edhe në hallkën më të lartë të miratimit të planeve mësimore – Senatin Akademik – ku njëri prej anëtarëve është përfaqësues nga studentët. Përfaqësuesi i studentëve në senat u pyet nga GVJ në lidhje me mënyrën e përfaqësimit, ai siguroi se përcjell reagimet e studenteve për problematika të ndryshme nga kurrikulat e deri tek metoda e mësimdhënies dhe shpërndarja e moduleve gjatë vitit akademik. (Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL).			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit për metodat e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. KUR ka të përcaktuar qartë edhe në rregulloren e programit të studimit modalitetet e këtij procesi, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës të lëndës/modulit. Çdo provim parashikon edhe ditën e dhënies së rezultatit individualisht ku studenti ka të drejtën edhe të ankimimit. (Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL).			
Konkluzione	<i>KUR përfshin dhe angazhon studentët në vendimmarrje në lidhje me hartimin dhe mënyrën e zhvillimit të programit sikurse metodat e mësimdhënies dhe cilësinë e lekturimit dhe materialeve në dispozicion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Zyra e karrierës ofron këshillim individual dhe grupal: përgatitjen për intervistat, hartimin e CV-së, dhe zhvillimin e aftësive të tyre të karrierës. Ndiheja në gjetjen e punës dhe praktikave: Asistimi në kërkimin dhe aplikimin për praktika pune ose pozita të punës, duke ofruar burime për të gjetur mundësi të karrierës në fushën e tyre të interesit. Rrjetizimi: Inkurajimi i studentëve për të ndërtuar rrjetet e tyre profesionale duke lidhur studentët me profesionistë, alumni të universitetit dhe organizata që mund të ofrojnë mundësi për t'u zhvilluar profesionalisht. (Evidenca 7. Rregullore e Këshillimit të Karrierës).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të	Zyra e Këshillimit të Karrierës përditëson studentët me informacion të hollësishëm mbi mundësitë e pjesëmarrjes në

posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	trajnime profesionale, forume rinore, aplikimet e mundëshme në konferencat vendase, rajonale dhe ndërkombëtare, etj. (Evidenca 7. Rregullore e Këshillimit të Karrierës).			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e këshillimit të karrierës në Fakultet është një strukturë ku studentët mund të marrin informacion në lidhje me trajnimet, praktikat apo ofertat e punësimit. Kjo zyrë mirëpret, informon dhe orienton studentët në lidhje me aspekte të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Nga ana tjetër kjo zyrë merr përsipër të njoftojë dhe ndjekë studentët në lidhje me aktivitete me karakter shkencor apo trajnimi për përditësimin e njohurive të tyre. Zyra siguron mundësi të ndryshme trajnimi, mobiliteti, projektsh dhe bashkëpunon ngushtë me këshillat studentorë. (Evidenca 7. Rregullore e Këshillimit të Karrierës).			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Institucioni lehtëson në punësimin e studentëve të tij edhe brenda IAL, por edhe me punëdhënës të ndryshëm. Zyra e Karrierës dhe Alumni ndihmon studentët të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes, për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës. KUR ka marrëveshje të lidhura me farmaci private për zhvillimin e praktikave profesionale për studentët dhe ofrimin e kontratave të punës pas diplomimit të tyre. Zyra mban rregullisht të dhëna rreth shkallës së punësimit të studentëve sipas degëve e viteve të tyre të diplomimit dhe gjatë intervistës u puhua se shkalla e punësimit është gati 100% për studentët e diplomuar në KUR. (Evidenca 7. Rregullore e Këshillimit të Karrierës).			
Konkluzione	<i>Ndjekja e ecursisë, këshillimi në aftësimin e studentëve me njohuri për tregun e punës është i vazhdueshëm. KUR krijon rrjetëzimin me ALUMNI dhe kompanitë potenciale për tregun e punës dhe mbledh këto të dhëna rregullisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	KUR ka hartuar disa udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, si manuali i zhvillimit të mësimin në distancë, apo udhëzuesin për punimin e diplomës. (Evidenca 16. Google Classroom Manuali student; Evidenca 17. Google Classroom Manual pedagogu; Evidenca 18. Manual për programin OBS për regjistrim Video dhe audio).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	KUR ka ngritur dhe ka funksional Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila synon të sigurojë përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme në nivel institucioni. NJSBC funksionon në bazë të rregullores së saj, dhe në përfundim të vitit akademik harton raportin vjetor të cilin ia paraqet rektorit, së bashku me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti i NJSBC-së hartohet bazuar në anketimet e vazhdueshme të studentëve dhe në rezultatat e monitorimit të kryera nga Njësia gjatë vitit akademik. Departamenti inkurajon kualifikimin e personelit akademik në fushën e mësimdhënies dhe në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. (Evidenca 8. Rregullores se Zyres se Marredhenieve Nderkombetare; Evidenca 9. Rregullore NJSBC; Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC; Evidenca 73. Formular NJSBC - Vleresim i studentit per pedagogun).
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, nëpërmjet anketimeve dhe pyetësorëve që plotësohen nga studentët në mënyrë anonime. Çdo vit nga NJSBC përfshihen nëpërmjet pyetësorit të gjithë studentët të cilët shprehin mendimet e tyre në mënyrë të lirë dhe vullnetare. (Evidenca 73. Formular NJSBC - Vleresim i studentit per pedagogun; Evidenca 74. Model pyetësori për studentët, i hartuar nga NJSBC).
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Raporti i NJSBC është publik dhe i aksesueshëm në faqen web të KUR. (Evidenca 9. Rregullore NJSBC; Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC; Evidenca 73. Formular NJSBC - Vleresim i studentit per pedagogun).
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rezultatet diskutohen dhe shoqërohen me komente dhe menyra që	Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rezultatet diskutohen dhe shoqërohen me komente dhe menyra që

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	cojne ne adresimin dhe përmirësimin e mangësive të gjetura. (Evidenca 108. Plan Masash për zbatimin kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit KUR).			
Konkluzione	<i>KUR garanton cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet mekanizmave të ngritura, NJSBC, e cila monitoron dhe raporton gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. KUR ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në zbatim të ligjit për arsimin e lartë LAL 80/2015, neni 103, standardeve shtetërore të cilësisë (Kodit të cilësisë), standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë (ESG), KUR implementon dhe zbaton një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë. Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e tij përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies. (Evidenca 2. Statuti KUR).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Njësi e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton procedura dhe politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kodin e cilësisë. NJSBC është organi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe bashkëpunon me përfaqësuesit e saj në çdo njësi kryesore. Përgjegjësit e departamenteve në përfundim të vitit akademik plotësojnë performancën e stafit akademik përkatës. Për secilin pedagog me kohë të plotë dhe të pjesshëm bëhet vlerësimi sipas formularit të performancës, plotësimi i së cilit bazohet në përgatitjen në kohë të syllabuseve, literaturës së përdorur, zhvillimi i leksioneve, praktikave, seminareve dhe laboratoreve, respektimi i orarit të mësimin, udhëheqjet për detyra kursi apo tema diplome. Paralelisht edhe titullarët e lëndëve plotësojnë formularët e performancës për stafin me kohë të pjesshme që ata aktivizojnë në lëndët përkatëse i cili merret parasysh në procesin e rekrutimit të tyre në vitin akademik pasardhës. Plotësimi i performancës së stafit akademik i bëhet me dije Dekanit dhe depozitohet në Dekanat. Në

	përfundim të këtij procesi është hartuar raporti paraprak i cili është vënë në dispozicion të titullarit të fakultetit. Të gjithë analizat /raportet/të dhënat e dala nga procese vlerësimi janë pjesë e raporteve vjetore në nivel departamenti/fakulteti/universiteti, duke evidentuar problematika sipas aspekteve dhe adresuar ato për zgjidhje, proces ky i vazhdueshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë. (Evidenca 2. Statuti KUR; Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2021 – 2026; Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL; Evidenca 69. Struktura e NJSBC perberja dhe kompetencat; Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC).			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë sikundër është përcaktuar në Kodin e cilësisë dhe Manualin e vlerësimit të jashtëm të hartuar nga agjencia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ASCAL. KUR, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes, dhe cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si, sondazhe e intervista të studentëve. Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga të anketuarit përpunohen nga NJSBC dhe i paraqiten autoriteteve drejtuese në IAL për njohje dhe vlerësim. (Evidenca 9. Rregullore NJSBC; Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC; Evidenca 73. Formular NJSBC - Vlerësim i studentit për pedagogun; Evidenca 74. Model pyetësori për studentët, i hartuar nga NJSBC).			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Politikat, procedurat për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit që ofron UMT, janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e NJSBC (Evidenca 2. Statuti KUR; Evidenca 4. Rregullore e Përgjithshme e IAL; Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC) dhe në aktet rregullatore të institucionit.			
Konkluzione	KUR harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit falë strukturave të brendshme si NJSBC, departament dhe mekanizmeve të matjes së performancës, anketime dhe raportet vjetore të mësim-kërkimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të nxëniet.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	KUR përdor mekanizma dhe procese formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit. Raportimet periodike, diskutimet në Departamente dhe Dekanat, janë pjesë e proceseve të vazhdueshme që zhvillohen për garantimin e ecurisë së programit. Në analizën vjetore të njësive bazë dhe fakultetit, ecuria e programeve në tërësi analizohet dhe jepen të dhëna në formë përshkrimore dhe sasiore për aspekte të ndryshme të ofrimit të tyre. Pjesë të kësaj analize janë përmbledhje për personelin akademik të angazhuar në program, përditësimi i literaturës së programit, rezultatet e studentëve (kalueshmëria dhe nota mesatare), marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, infrastruktura në funksion të programit, duke e përmbyllur raportin me analizën përfundimtare dhe plan masash për përmirësim.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, në përfundim të çdo viti akademik, Drejtoria e Kurrikulave nis procesin e përditësimit të programeve në nivel institucional me qëllim rritjen e cilësisë në përmbajtje të tyre. Në raportin vjetor në nivel universiteti, NJSBC, si strukturë përgjegjëse, analizon dhe vlerëson përputhshmërinë e programit të studimit me standardet shtetërore të cilësisë për programet dhe për institucionin. Ky raport është subjekt i diskutimeve në mbledhjen e organeve kolegjiale të KUR (Senat Akademik dhe Bordi i Administrimit), ku evidentohet qartë plani i masave me strukturat përgjegjëse dhe afatet e realizimit.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	KUR në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Departamenti, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor mënyra të tjera vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (ALUMNI), të personelit akademik, ndihmës-akademik, drejtuesit e farmacive që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutura nga ky program.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit	KUR merr pjesë gjithashtu në zhvillimin e sondazheve në nivel kombëtar, që zhvillohen nga ASCAL. Për këtë qëllim IAL ngre

të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	grup pune, i cili asiston studentët në orientimin e procesit të sondazheve, si dhe u krijon mundësi që në anonimanitet të plotë të plotësojnë pyetësorët. (Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC; Evidenca 79. Urdhri per ngritjen e Grupit te Vleresimit te Brendshem per hartimin e RVB; Evidenca 108. Plan Masash për zbatimin kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit KUR; Evidenca 109. Relacion - për realizimin e detyrave të planifikuara në planin e masave Për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor).			
Konkluzione	KUR në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve me qëllim garantimin e objektivave formuese dhe rezultateve të kënaqshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	IAL nëpërmjet NJSBC garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Detyrat dhe funksionimi i NJSBC në IAL janë të përcaktuara në Rregulloren e NJSBC, miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017, të Senatit Akademik. (Evidenca 9. Rregullore NJSBC; Evidenca 76. Pyetësor per performancën e mesimdhënien).
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Detyrat konkrete të NJSBC parashikohen në nenet 5 dhe 6 të rregullores së NJSBC. Vlerësimi i programeve të studimit dhe personelit akademik bazohet në kriteret e mëposhtme: Vlerësim nga njësia kryesore mbi bazën e raportit të hartuar nga njësia bazë në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e



	bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen. ▪ Vlerësimi nga drejtuesi i departamentit – çdo fund viti drejtuesi i departamentit, harton një raport përmbledhës për secilin pedagog, në të cilin konsiderohen: vlerësimi mesatar i marrë nga pyetësorët drejtuar studentëve, vlerësimi mbi korrektësinë e realizimit të orëve të mësimit përmes raportit semestral të hartuar nga pedagogët. (Evidenca 9. Regullore NJSBC; Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC).
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo miratohet me vendim të SA dhe përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët tre janë përfaqësues të personelit akademik, një përfaqësues i Këshillit Studentor dhe një ekspert i jashtëm. Gjithashtu, siguri i cilësisë në KUR inicion në nivel Njësie Bazë me ngritjen e grupeve ad-hoc të cilët merren me çështje si, rishikimi dhe përditësimi i syllabuseve dhe kurrikulave, vlerësimi i programit të studimit dhe çështje të tjera që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe procesit mësimor e kërkimor shkencor. Në grup futen dhe përfaqësues i studentëve të cilët janë në vitin e fundit të studimit. (Evidenca 9. Regullore NJSBC; Evidenca 70. VS per perberjen e NJSBC; Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC).
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Vlerësimi i studentët dhe stafit akademik bëhet mbi bazën e meritokracisë. Në përzgjedhjen e anëtarëve në proceset ciklike të vlerësimit janë patur parasysh kompetencat profesionale, vlerësimi i paanshëm dhe objektiv, aftësitë analitike, shkalla e njohjes së institucionit dhe veprimtarive të tij, si dhe eksperiencia të mëparshme në veprimtari të ngjashme vlerësuese. Rëndësi i kushtohet njohjes dhe zbatimit të Kodit të Etikës (Evidenca 15. Kodi i Etikës; Evidenca 77. Raport vlerësimi ne programin e integruar te studimeve Msc. Farmaci).
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	NJSBC në përbërje të saj ka një ekspert të jashtëm, i cili jep kontribut në hartimin e pyetësorëve dhe përpunimin e raporteve të kësaj strukture. Kjo është e parashikuar edhe në statutin e IAL (Evidenca 2. Statuti KUR; Evidenca 70. VS per perberjen e NJSBC).

Konkluzione	<i>IAL garanton përfshirjen e palevë të interesit, stafit dhe studentëve në vlerësimin e cilësisë, informon për rezultatet dhe masat e marra për këtë aspekt.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni përmes proceseve të hapura dhe të bëra publike në faqen zyrtare të KUR, fton studentët dhe stafin akademik të njihen me procedurat që institucioni kryen në kuadër të sigurimit të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit dhe njëkohësisht kërkon që ata të përfshihen në mekanizmat e sigurimit të cilësisë në universitet. (Evidenca 72. Raport vjetor i NJSBC).
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	IAL në përfundim të çdo viti akademik publikon raportin vjetor të cilësisë, i cili hartohet nga struktura e NJSBC brenda institucionit. Ky raport përfshihet edhe në raportin vjetor të aktiviteteve të IAL (Evidenca 13. Rregullore për Mbrojtjen Perpunimin Ruajtjen dhe Sigurine e të Dhenave Personale – 2020).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Përveç informimit dhe publikimit të rezultateve që dalin nga analiza të ndryshme vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm, një aspekt mjaft i rëndësishëm është dhe adresimi i gjetjeve apo rekomandimeve të lëna në raportet përkatëse. Nëse këto gjetje kanë impakt në organizimin e institucionit dhe prekin aspekte të rëndësishme të funksionimit të tij, ato diskutohen në Senatin Akademik. Në rastet kur gjetjet kanë impakt financiar ato adresohen për vlerësim dhe vendimmarrje në Bordin e Administrimit. Në përgjithësi, pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat përkatëse, hartohet plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna. (Evidenca 108. Plan Masash për zbatimin kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit KUR).
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm dhe dinamik i cili kërkon përveç mekanizmave të konsoliduar edhe ndërgjegjësim të personelit akademik, administrativ dhe studentët. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në



	vijim të cilësisë së programit të studimit. (Evidenca 109. Relacion - për realizimin e detyrave të planifikuara në planin e masave Për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor).			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Takime periodike kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale të institucionit me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. (Vizita në institucion).			
Konkluzione	<i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente dhe efektive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Farmaci", ofruar nga Kolegji Universitar "REALD"

Pika të forta dhe afirmime:

1. Atmosfera akademike është pozitive dhe KUR demonstroi një shkallë të lartë kolegjaliteti.
2. Mjediset dhe infrastrukturë e përshtatshme për mbarrëvajtjen e një kurrikule të tillë.
3. Përfshirja e disa partnerëve industrialë dhe privat për praktikën dhe kontributin në mësimdhënie.
4. Mekanizmat dhe aktivitetet rreth mbështetjes së studenteve. Studentët kanë lënë përshtypje tek GVJ se ndihen jashtëzakonisht të suportuar nga IAL.

Pika të dobëta:

1. Koordinator i programit të studimit është personeli akademik me kontratë (PAK), nuk mban të paktën gradën shkencore "Doktor" dhe në vendimin e emërimit të tij nuk është caktuar përgjegjësi e tij për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit, por është përgjegjës vetëm për praktikën profesionale, duke mos qënë kështu në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi. **(Standardi II.2, kriteri 3);**
2. Institucioni ka angazhuar në mësimdhënie personeli akademik jo me grada/tituj, jo të gjithë titullarët e lëndëve janë të kategorisë "Profesor", si dhe, edhe pse KUR ndjek politikë për të qënë konkurrense dhe tërheqës si IAL për burime njerëzore cilësore duke investuar në rritjen profesionale gjatë viteve, ka jo qëndrueshmëri në staf akademik me kohë të plotë. **(Standardi III.1, kriteri 4; Standardi IV.1, kriteri 1; Standardi IV.1, kriteri 3);**
3. Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik të këtij programi studimi, u evidentuan në disa raste mospërputhjet/problematikat si në vijim:
 - Kohëzgjatja e kontratës së disa prej anëtarëve të personelit akademik nuk është në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi lidhur me kategorinë e personelit;
 - Kontratat e personelit akademik, nga ana e KUR, janë të fimosura nga Kryetari i Bordit të Administrimit dhe jo nga Rektori, sikurse kërkuar nga legjislacioni në fuqi;
 - Në dosjet e personelit akademik me kontratë (PAK) mungon leja nga punëdhënësi. **(Standardi IV.1, kriteri 6);**
4. Literatura e përdorur për pjesën më të madhe të moduleve është literaturë e vjetër, si dhe përditësimet në literaturë nuk rezultojnë të jenë realizuar për të gjithë lëndët e programit të studimit. **(Standardi IV.3, kriteri 1 dhe 2).**
5. Përfshirja e studentëve në kërkim shkencor nuk është në nivelin e duhur dhe kërkimi shkencor i personelit akademik është më tepër si rezultat i nismave individuale të tyre. Gjithashtu, KUR nuk ka të parashikuar një fond të dedikuar për mbështetje të kërkimit shkencor. **(Standardi II.6, kriteri 3; Standardi II.7, kriteri 2; Standardi IV.5, kriteri 5).**



Rekomandime:

1. Institucioni, të marrë masa për caktimin në detyrë të një Koordinatori programi, i cili të përmbushë parashikimet ligjore në fuqi lidhur me llojin e punësimit të tij dhe kategorinë, dhe që në përgjegjësitë e tij të ketë jo vetëm mbikëqyrjen e praktikës profesionale, por edhe ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit **(Standardi II.2, kriteri 3)**;
2. Institucioni, të marrë masa që të angazhojë në mësimdhënie në këtë program studimi vetëm personel akademik me grada/tituj dhe të caktojë titullarë të lëndëve personel akademik të kategorisë “Profesor”, sikurse kërkuar nga legjislacioni në fuqi. Rritja e mbështetjes për trajnim dhe avancim në grada e tituj për personelin akademik do të sigurojë edhe rritje të qëndrueshmërisë së personelit akademik me kohë të plotë. **(Standardi III.1, kriteri 4; Standardi IV.1, kriteri 1; Standardi IV.1, kriteri 3)**;
3. Institucioni, duhet të rishikojë dhe analizojë problematikat e evidentuara në dosjet e personelit akademik lidhur me kontratat e personelit dhe mangësitë në dokumentacion dhe të marrë masa për saktësimin dhe plotësimin e tyre. **(Standardi IV.1, kriteri 6)**;
4. Institucioni, të marrë masa për përditësimin e literaturës së përdorur në lëndët e këtij programi studimi me qëllim që ajo të jetë e pesë viteve të fundit, si dhe më shumë vëmendje i duhet dedikuar përditësimit të literaturës në mënyrë të herëpashershme nga titullarët e lëndëve. **(Standardi IV.3, kriteri 1 dhe 2)**;
5. Një fond i dedikuar për mbështetjen e kërkimit shkencor duhet të jetë në propozimet e çdo viti akademik në vazhdim nga ana e IAL-së. IAL duhet të marrë masa për përfshirjen më tepër të studentëve dhe personelit akademik të programit të studimit në punë kërkimore apo projekte të ndryshme kërkimore, përfshirjen në mobilitet nëpërmjet programeve ERASMUS, etj. **(Standardi II.6, kriteri 3; Standardi II.7, kriteri 2; Standardi IV.5, kriteri 5)**;
6. Institucioni, duhet të adresojë parregullsitë e evidentuara lidhur me regjistrat dhe dosjet e studentëve dhe të sigurojë një kontroll të brendshëm të institucionit më efektiv në shqyrtimin e dokumentacionit dhe shmangien e gabimeve qofshin ato njerëzore. **(Standardi V.4, kriteri 2)**;
7. Institucioni, të marrë masa për sigurimin e një sistemi antiplagjiaturë. **(Standardi III.3, kriteri 5)**.

Evaluation's conclusions for the second cycle integrated study program Master of Science in "Pharmacy", provided by the Higher Education Institution University College "REALD"

Strengths and affirmations:

1. The academic atmosphere is highly positive, KUR demonstrates a high degree of collegiality.
2. Appropriate environment and teaching facilities for such a curriculum.
3. Involvement of several local industrial and private partners for internships and contribution to teaching.
4. Mechanisms and activities in place related to student support. These have been evidenced clearly and students left an impression on the external evaluation group that they are very supported.

Weaknesses:

1. The coordinator of the study program is academic staff with a contract (PAK), does not hold at least the academic title "Doctor", and in the decision of his appointment, his responsibility for the progress and development of the study program is not specified, he is solely responsible for professional practice, thus not in compliance with current legal/sub-legal acts. **(Standard II.2, criterion 3);**
2. The institution has engaged academic staff without degrees/titles, not all subject holders have the category "Professor" and although it follows a policy to be competitive and attractive as an HEI for quality human resources by investing in professional development over the years, there is instability in the full-time academic staff. **(Standard III.1, criterion 4; Standard IV.1, criterion 1; Standard IV.1, criterion 3);**
3. From the examination of the files of academic staff in this study program, inconsistencies/problems were identified in several cases as follows:
 - The duration of the contracts of some members of academic staff is not in line with the provisions of current legislation regarding staff category;
 - Contracts of academic staff, by the institution, are signed by the Chairman of the Board of Administration and not by the Rector, as required by current legislation;
 - In the files of academic staff with contract (PAK), there is a lack of approval from the employer. **(Standard IV.1, criterion 6);**
4. The literature used for the majority of modules is outdated, and updates in literature do not seem to have been implemented for all subjects of the study program. **(Standard IV.3, criterion 1 and 2).**
5. The inclusion of students in scientific research is not at the appropriate level, and the scientific research of academic staff is more of a result of their individual initiatives. Also, the institution has not allocated a dedicated fund to support scientific research. **(Standard II.6, criterion 3; Standard II.7, criterion 2; Standard IV.5, criterion 5).**

Recommendations:

1. The institution should take measures to appoint a Program Coordinator who complies with current legal provisions regarding the nature of his employment and category. The Coordinator's responsibilities should include not only overseeing professional practice but also the progress and development of the study program (**Standard II.2, criterion 3**).
2. The institution should take measures to engage in teaching in this study program only academic staff with degrees/titles and appoint subject holders as academic staff of the "Professor" category, as required by current legislation. Increasing support for training and advancement in degrees and titles for academic staff would also ensure the sustainability of full-time academic staff (**Standard III.1, criterion 4; Standard IV.1, criterion 1; Standard IV.1, criterion 3**).
3. The institution should review and analyze the issues identified in the files of academic staff regarding staff contracts and deficiencies in documentation, taking measures to correct and complete them (**Standard IV.1, criterion 6**).
4. The institution should take measures to update the literature used in the subjects of this study program so that it reflects the last five years. More attention should be given to updating literature regularly by subject holders (**Standard IV.3, criterion 1 and 2**).
5. A dedicated fund for supporting scientific research should be included in the proposals for each academic year by the institution. The institution should take measures to involve more students and academic staff from the study program in research work or various research projects, including participation in mobility programs such as ERASMUS, etc. (**Standard II.6, criterion 3; Standard II.7, criterion 2; Standard IV.5, criterion 5**).
6. The institution should address irregularities identified in the records and files of students and ensure an effective internal control system for reviewing documentation and avoiding errors, whether human-made or otherwise (**Standard V.4, criterion 2**).
7. The institution should take measures to implement an anti-plagiarism system (**Standard III.3, criterion 5**).



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X